

**Dita e Evropës
përmbillet me ecje në
sheshet e kryeqytetit**



PRESIDENTI I
KOSOVËS,
HASHIM THAÇI,
ËSHTË PRITUR
NË TAKIM NGA
KANCELARJA E
GJERMANISË,
ANGELA MERKEL

Thaçi kërkon përkrahjen e Merkelit në dialogun Kosovë - Serbi



- Porosia e Merkelit: Kosova ta luftojë korrupsionin dhe ta ulë papunësinë

Kancelarja gjermane Angela Merkel ka kërkuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo ka thënë se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve janë temë qendrore për përafrimin me Bashkimin Evropian. Këto komente kancelarja Merkel i ka bërë të mërkurën në Berlin pas takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë të përbashkët për medie. Merkel ka vlerësuar se që nga shpallja e pavarësisë Kosova ka arritur shumë, megjithatë ajo ka bërë thirrje për sundim të ligjit, luftim të krimit dhe korrupsionit si dhe ulje të papunësisë. Ndërkaq Thaçi ka kërkuar përfshirjen e Gjermanisë me një rol aktiv në procesin e dialogut Kosovë - Serbi

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**EPOPEJA E GRYKËS
SË LLAPUSHNIKUT,
SINONIM I LAVDISË,
KRENARISË DHE
QËNDRESËS
SË UÇK-SË F. 11**



SHKRUAN: FERAT SHALA

**HARADINAJ: ILIR
KONUSHEVCI E HAZIR MALA
ISHIN PLANIFIKUES TË
RRUGËS PËR LIRI F. 6**

**GJENERALMAJORI ORR
PËRGËZON FSK-NË PËR TË
ARRITURAT F. 7**

EKONOMI

**KËRKOHEZ ZBATIMI
I VENDIMIT TË MTI-së PËR
QUMËSHTIN F. 8**

**QEVERIA E KUAJTIT DO TA
NDIHMOJË KOSOVËN NË
PUNËSIM F. 9**

KULTURË

**E DREJTA PËR TË PASUR
TË DREJTË F. 16**

VALBONA NATHANAILI

SPORT

**KARATEISTËT E KOSOVËS
NDALOHEN DY HERË TË MOS
HYJNË NË SERBI F. 18**

Qeveria e kënaqur me punën e zëvendësministrave

Zyra e Kryeministrit është shprehur e kënaqur me punën që deri më tani kanë bërë zëvendësministrat, numri i të cilëve arrin në 80 sish. Në bazë të raporteve të punës që i kanë dorëzuar në zyrën e kryeministrit,

Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shihet se zëvendësministrat kanë pasur angazhime serioze. Edhe zëvendësministrat të cilët janë

kontaktuar nga gazeta kanë mbrojtur punën e vet gjatë kësaj periudhe kohore të qeverisjes. Por, njohësit e rrethanave politike mendojnë se zëvendësministrat me punën e tyre nuk i arsyetojnë as pagat që marrin



Shpend Ahmeti zgjedhet kryetar i PSD-së

Kuvendi i jashtëzakonshëm i Partisë Socialdemokrate (PSD), e cila deri më sot u drejtua nga Kaqusha Jashari, të mërkurën

zgjodhi me shumicë votash kryetar Shpend Ahmetin, nënkryetar Visar Ymerin dhe sekretare të përgjithshme Aida Dërgutin

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Dita e Evropës përmbillet me ecje në sheshet e kryeqytetit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 MAJ - Pas përmbylljes së aktiviteteve treditore, kushtuar Ditës së Evropës, ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka theksuar se secili nga ne duhet të angazhohemi që vitin e ardhshëm, kur ta shënojmë Ditën e Evropës, vendi ynë, Kosova, të jetë më afër Bashkimit Evropian edhe me punë, edhe me vepra.

Në ditën e tretë të shënimit të Ditës së Evropës, ministrja Hoxha ka filluar me ecjen në sheshin e kryeqytetit së bashku me ambasadorë dhe përfaqësues të BE-së. "Aty na priti një performancë e këndshme, ku nga të rinjtë u ekzekutua Himni i Evropës. Koncerti i 'Okarinës' nga fëmijët në shesh, na frymëzoi për të ardhmen e ndritur të vendit tonë. Së bashku me mysafirët kemi vizituar Panairin e Grave Ndërmarrëse, të cilat meritojnë mirënjohje të veçantë. Për nder të Ditës së Evropës, pas konkur-



sit, kemi shpërblyer punimet më të suksesshme të nxënësve dhe storiët e gazetarëve kushtuar kësaj dite", ka thënë Hoxha.

Ajo në fund të këtij aktiviteti ka dhënë edhe mirënjohje për gratë ndërmarrëse, pjesëmarrëse në panair. "Falënderoj të gjithë ata që u angazhuan që kjo ditë të shënohet sa më mirë, gratë ndër-

marrëse, të rinjtë, nxënësit dhe mediet. Secili nga ne duhet të angazhohemi që vitin e ardhshëm, kur ta shënojmë Ditën e Evropës, vendi ynë, Kosova, të jetë më afër Bashkimit Evropian edhe me punë, edhe me vepra", ka thënë ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha.

Vuçiçi kërkon ndihmën e Putinit për Kosovën

MOSKË, 9 MAJ - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, tha se Rusia pa hamendje dhe qartazi do t'i paraqesë qëndrimet e veta për Kosovën dhe do ta ndjekë tërë procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Ai i bëri këto komente pas takimit me presidentin rus Vladimir Putin në Moskë, ku po merr pjesë në manifestimet me rastin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Presidenti serb vuri theksin te marrëdhëniet e ngrohta ndërmjet dy vendeve duke vlerësuar veton që Rusia i vuri në vitin 2015 rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për ta cilësuar masakrën e Srebrenicës në Bosnjë si gjenocid.

Presidenti serb është ndër udhëheqësit e paktë të shteteve që do të marrin pjesë në manifestimet e 9 majit në Moskë, që po bojkotohen nga shumë udhëhe-



qës botërore për shkak të tensioneve pas helmimit të spiunit rus në Londër, Sergei Skripal, por edhe tensioneve diplomatike që lidhen me veprimtaritë ruse në pjesë të ndryshme të botës.

Ai tha pas takimit se pa Rusinë është e pamundur të arrihet çfarëdo zgjidhjeje për Kosovën. "Ja përsërita disa herë Putinit se

Serbia është e gatshme për kompromis me shqiptarët e Kosovës, porse nuk është dhe kurrë nuk do të jetë e gatshme ta pranojë poshtërimin e saj. E lutëm Putinin që Rusia si një nga shtetet më të rëndësishme dhe më të fuqishme në Kombet e Bashkuara, të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të Kosovës", tha Vuçiçi.

LAJME SHKURT

Meta: Shpresoj hapjen e negociatave në qershor

TIRANË, 9 MAJ - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka marrë pjesë në hapjen e sezonit turistik në bashkinë e Çorovodës, në Skrapar. Ai shoqërohej nga disa ambasadorë të huaj dhe është pritur nga kreu i bashkisë dhe



qytetarët e zonës. "Promovim potenciale dhe resurse turistike të zonës, nga vlerat e kulinarisë të ushqimeve bio e deri te të pakrahasueshmet Kanionet e Osunit, si pasuri kombëtare unike dhe me vlera të jashtëzakonshme turistike. Sportet rekreative si rafting shërbejnë si reklama më e mirë për turistët vendës dhe të huaj të cilët, pasi eksplorojnë për herë të parë këto bukuri mahnitëse, duan të rikthehen sërish. Bujqësia, turizmi, agro-turizmi dhe industria e lehtë përpunuese janë sektorë vitalë për t'i mbështetur ekonominë familjare dhe punësimin e qytetarëve të zonës", u shpreh Meta në fjalën e tij.

Nga Skrapari ai ka uruar ditën e Evropës, por edhe Ditën e Fitores mbi Fashizmin, duke shprehur besimin për çeljen e negociatave në muajin qershor. "Skrapari, krahina e parë e Shqipërisë e çliruar nga partizanët. Shpresoj në çeljen e negociatave në muajin qershor. Të punojmë fort e të bashkuar për realizimin e prioriteteve kyçe", ka thënë Meta.

Rama: Do të ishte më e lehtë po të kishte negociata me ShBA-në

TIRANË, 9 MAJ - Duke folur në aktivitetin për "Trashëgiminë kulturore" në Ditën e Evropës, kryeministri shqiptar Edi Rama tha se do të ishte më e lehtë nëse do të kishte negociata për t'u bërë pjesë e ShBA-së, pasi nuk do të duhej të



bindeshin 27 koka. "Po të kishte negociata për t'u bërë pjesë e ShBA-së mund të kishte qenë më e lehtë, mbase. Sepse nuk do të duhej të bindnim 27 koka dhe sot më vjen mirë të kujtoj se presidenti i Këshillit Evropian para pak ditësh këtu në Tiranë gjeti fjalët jo vetëm më të mira, po dhe më të goditura për të na inkurajuar në këtë proces ku tha se sot ne jemi mbase shumë më evropianë sesa të tjerë që janë pjesë e BE-së", tha ai.

Duke folur për zyrtarët gjermanë që kanë folur me skepticizëm për anëtarësimin e Shqipërisë, Rama tha se janë koka lajmesh në Shqipëri, por në vendin e tyre nuk u bie radha. "Nuk ka diskutim se për Shqipërinë sot, dhe fëmijët tanë nesër, ky është projekti më pozitiv i imagjinueshëm për të cilin ia vlen çdo sakrificë, çdo përpjekje dhe i gjithë durimi për të dëgjuar edhe më të fundit fare, që bëhet personazh dhe zë i ekrameve dhe lajmeve të para në Shqipëri, ndërkohë që në vendin e vet si bie radha kurrë të dalë në lajme", tha Rama.

Osmani: Vendi do të jetë në rrezik nëse nuk anëtarësohet në NATO e BE

SHKUP, 9 MAJ - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, përshëndetet përpjekjet e Maqedonisë dhe

Greqisë për zgjidhjen e çështjes së emrit, duke thënë se nëse problemi merr fund, vendi do të anëtarësohet në

NATO. Kryeministri Zoran Zaev pret që qëndrimet e palëve të afrohen gjatë negociatave të së shtunës mes

kryediplomatëve dhe ndërmjetësit të OKB-së. Në shënimin e "Ditës së Evropës", zëvendëskryeministri për

Çështje Evropiane, Bujar Osmani, tha se vendi mund të vihet në rrezik nëse nuk bëhet pjesë e NATO-s dhe BE-së.

Zëvendësministrat i kanë dorëzuar raportet e punës së tyre në zyrën e kryeministrit

Qeveria e kënaqur me punën e zëvendësministrave

Zyra e Kryeministrit është shprehur e kënaqur me punën që deri më tani kanë bërë zëvendësministrat, numri i të cilëve arrin në 80 sish. Në bazë të raporteve të punës që i kanë dorëzuar në zyrën e kryeministrit, Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shihet se zëvendësministrat kanë pasur angazhime serioze. Edhe zëvendësministrat të cilët janë kontaktuar nga gazeta kanë mbrojtur punën e tyre gjatë kësaj periudhe kohore të qeverisjes. Por, njohësit e rrethanave politike mendojnë se zëvendësministrat me punën e tyre nuk i arsyetojnë as pagat që marrin

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 MAJ - Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, është shprehur i kënaqur me punën e zëvendësministrave, numri i të cilëve arrin në 80 sish. Ai ka treguar për gazetën "Epoka e re" se në bazë të asaj që ka parë në raportet e dorëzuara në zyrën e kryeministrit, shihet se ata kanë pasur angazhime serioze. Edhe vetë zëvendësministrat kanë mbrojtur punën që kanë bërë, duke thënë se kanë pasur angazhime me përgjegjësi të larta. Mirëpo, njohësit e rrethanave politike mendojnë ndryshe për punën e zëvendësministrave. Sipas tyre, ata nuk kanë mundur t'i arsyetojnë as pagat që marrin. Besnik Tahiri ka bërë me dije se deri më tani gati të gjithë zëvendësministrat i kanë dorëzuar raportet e punës së kërkuar nga kryeministri Ramush Haradinaj. "Kjo pyetje do të duhej t'u shtrohet ministrave dhe kryeministrit, sepse ata janë drejtpërdrejt përgjegjës për punën e zëvendësministrave. Por, prej punës që ata kanë prezantuar në raportet e tyre tregojnë se kanë pasur angazhim serioz. Ka ministri që zëvendësministrat kanë pasur punë shumë konkrete, aty ku janë koordinatorë të temave të caktuara dhe udhëheqës të projekteve të caktuara", ka thënë Tahiri, duke u shprehur i kënaqur me punën që ata kanë bërë deri më tani. "Nga ajo çka kam parë në raporte, jam i kënaqur me punën e zëvendësministrave, por ky është vetëm një vlerësim personal, sepse vlerësimin për punën e tyre duhet ta japin ministrat dhe kryeministri", është shprehur ai. Tahiri ka folur edhe për rastet ku disa nga zëvendësministrat në raport kanë cekur edhe deklarimet nëpër medie të

ndryshme. "Në raporte nuk janë vetëm deklaratat, por aty përshkruhen punët dhe pozicioni i tyre publik. Secili zëvendësministër e ka fuqinë e vet politike dhe për përgjegjësitë e veta, ku ai raporton publikisht nëpër medie për hir të transparencës në punët e tyre ditore si zëvendësministër", ka thënë Tahiri. Zëvendëskryeministrat kanë mbrojtur punën që kanë bërë deri më tani, duke thënë se me përgjegjësi të lartë kanë kryer të gjitha ato punë që u janë deleguar nga ministrat e tyre. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme që vjen nga radhët e PDK-së, Izmi Zeka, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se raporti i punës së tij është fokusuar në tri drejtime: takimet me miqtë ndërkombëtarë, angazhimi në strategjinë për migrim, riatdhesim dhe armë, si dhe në politikëbërjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme. "Raportin për 100-ditëshin e kam dorëzuar në Qeveri. Angazhimi im në 100-ditëshin e parë të kësaj Qeverie ka konsistuar në disa drejtime. Aspekti i parë kanë qenë takimet e pareshtura me miqtë ndërkombëtarë që asistojnë në punët e MPB-së dhe japin ekspertiza të përditshme. Aspekti i dytë ka qenë angazhimi im në strategjitë për migrim, riatdhesim dhe armë. Dhe, aspekti i tretë, në politikëbërjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Çështje me rëndësi ka qenë e draftligjit për të huajt që e kam iniciuar dhe koncept-dokumenti për Ligjin e MPB-së", ka thënë Zeka. Ai ka bërë me dije se për këto 100 ditë të qeverisjes janë bërë shumë punë. "Janë bërë shumë punë dhe angazhime të cilat do të duhej të flasim gjatë, sepse me një deklaratë është vështirë të paraqiten", ka thënë zëvendësministri Zeka. Edhe zëvendësministri i AKR-së në Ministrinë e Mjedisit dhe



Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matshi, ka treguar për gazetën "Epoka e re" punët që i ka bërë deri më tani. "Raportin e punës sime e kam dorëzuar bukur moti. Aty i kam përfshirë aktivitetet e mia kryesore me të cilat jam marrë prej se kam ardhur në këtë pozitë. Unë kam punuar në rregulloren e re për riorganizim të ministrisë, ku e kam udhëhequr grupin. Pastaj, jam marrë me Agjencinë Kadastrale dhe problemet që i ka pasur kjo agjenci. Kam punuar në projektin e menaxhimit të integruar të pellgut të Drinit. Po ashtu, jam marrë edhe me përgjegjësitë e tjera që më janë deleguar nga ministrja", është shprehur ai. Matoshi ka thënë se ka punuar më shumë se kolegët e tij zëvendësministra në këtë ministri. "Meqenëse unë dhe ministria i takojmë së njëjtës parti, për dallim prej zëvendësministrave të tjerë, volumi i punës sime ka qenë më i madh sesa i të tjerëve. Po ashtu, unë e zëvendësoj ministren sa herë që ajo nuk është aty, sikurse që jam i përfshirë në organizmin e punëve të përditshme në ministri", ka thënë Matoshi. Mirëpo, ndryshe e ka parë

punën e zëvendësministrave analisti politik, Behxhet Shala. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se zëvendësministrat nuk i arsyetojnë as pagat e tyre. "Nuk ka shans që këta zëvendësministra t'i arsyetojnë shpenzimet që ia bëjnë shtetit, sepse fillimisht është dashur të ketë një ndarje strikte të punëve që duhet të bëjnë ata. Pra, një zëvendësministër është dashur të dijë se çfarë duhet të bëjë, pastaj të raportojë për punën që ka pasur. Kështu ata punojnë paushall, sillen paushall dhe shpenzojnë në mënyrë paushalle", ka thënë Shala. Sipas tij, Qeveria duhet t'i vlerësojë pozitive raportet e zëvendësministrave sepse duhet ta arsyetojë punën e tyre. "Në atë moment që Qeveria nuk është e kënaqur me punën e zëvendësministrave, atëherë ata duhet t'i çojë në shtëpi. Dihet se kryeministri Haradinaj pati deklaruar se gjithë këta zëvendësministra ia ka imponuar numri i madh i partive që përbëjnë koalicionin qeverisës. Deri më tani nuk besoj se i ka shqyrtuar të gjitha raportet e zëvendësministrave. Natyrisht se zëvendësministrat raportin e kanë shkruar ashtu

siç shkruan çdokush për veten", ka thënë Shala. Ai ka deklaruar se Kosova nuk ka nevojë për kaq shumë ministra dhe zëvendësministra. "Kosovës nuk i duhen kaq shumë ministra e as kaq shumë zëvendësministra. Numri kaq i madh i zëvendësministrave sjell probleme edhe për zyrë. Nuk e di se çfarë mund të bëjnë 4-5 zëvendësministra në një ministri. Ata mund ta pengojnë edhe njëri-tjetrin. Nuk ka asnjë mundësi që ata të punojnë mirë. Së paku në terren nuk po shihet se ata po bëjnë ndonjë punë të hairit. E keni parë se zëvendësministra janë emëruar ata njerëz që kanë dështuar në zgjedhje. Pra, ata që nuk kanë mundur të zgjedhen deputet apo kryetar të komunave, kurse tash janë rehatuar në Qeveri", ka thënë Shala. Kjo Qeveri është kritikuar që nga fillimi për numrin e madh të zëvendësministrave. Në këtë kohë Qeveria i ka rreth 80 zëvendësministra. Fillimisht kryeministri Ramush Haradinaj i kishte ftuar ministrat t'u gjejnë punë gjithë zëvendësministrave, më pas u ka kërkuar atyre raport për punën që kanë bërë deri më tani.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është pritur në takim nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel

Thaçi kërkon përkrahjen e Merk

- Porosia e Merkelit: Kosova ta luftojë korrupsionin dhe ta ulë papunësinë

Kancelarja gjermane Angela Merkel ka kërkuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo ka thënë se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve janë temë qendrore për përafrimin me Bashkimin Evropian. Këto komente kancelarja Merkel i ka bërë të mërkurën në Berlin pas takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë të përbashkët për medie. Merkeli ka vlerësuar se që nga shpallja e pavarësisë Kosova ka arritur shumë, megjithatë ajo ka bërë thirrje për sundim të ligjit, luftim të krimit e korrupsionit, si dhe ulje të papunësisë. Ndërkaq Thaçi ka kërkuar përfshirjen e Gjermanisë me një rol aktiv në procesin e dialogut Kosovë - Serbi

papunësisë. "Kemi tashmë 10 vjet që Kosova është shtet i pavarur dhe prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës mund të them se është arritur shumë. Më shumë se 100 shtete kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por kemi ende shumë probleme të pazgjidhura dhe ka hapa që duhet të ndiqen, mirëpo ka edhe përmirësime me rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. Kemi edhe shumë sfida para nesh, siç është luftimi i korrupsionit. Një problem shumë i madh është numri i lartë i papunësisë si dhe problemet e tjera që ndikojnë në

Perëndimor dhe perspektivës për integrim në Bashkimin Evropian është jetike që Kosova dhe Serbia t'i normalizojnë raportet ndërshtetërore dhe të zbatohen të gjitha marrëveshjet e arritura. Ai ka kërkuar përfshirjen e Gjermanisë me një rol aktiv në procesin e dialogut Kosovë - Serbi, duke thënë se Merkeli është shpresa e vetme për Ballkanin Perëndimor që të lëvizë më shpejt drejt perspektivës evropiane. "Porosia ime si president i Kosovës për shtetin e Gjermanisë dhe kancelaren Merkel është se ne jemi gati si

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 9 MAJ - Duhet të zbatohen marrëveshjet e arritura në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo ka qenë kërkesa e kancelares gjermane Angela Merkel pas takimit që ka pasur me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në Berlin. Në një konferencë të përbashkët për medie, ajo ka thënë se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve janë temë qendrore për përafrimin me Bashkimin Evropian. "Temë qendrore lidhur me përafrimin drejt Bashkimit Evropian janë marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Kjo, sipas pikëpamjes sime dhe sipas bisedës që kemi pasur, është një temë qendrore që nuk është temë aq e thjeshtë, por duhet të themi se ka pasur zhvillime pozitive edhe në këtë drejtim. Marrëveshjet e arritura deri më tani duhet të zbatohen dhe unë mendoj se aktualisht prioritet është edhe çështja energjetike dhe këto biseda do të zhvillohen gjatë takimit tonë në Sofje të Bullgarisë", ka deklaruar Merkel.



Kancelarja gjermane ka vlerësuar të arriturat e deritanishme të shtetit të Kosovës si dhe përmirësimet në rrugëtimin drejt BE-së, por Merkeli ka kërkuar sundim të ligjit, luftim të krimit e korrupsionit, si dhe ulje të

zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik", është shprehur Merkel.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se në kontekst të stabilitetit të Ballkanit

Kosovë ta hapim këtë kapitull për ta bërë hapin vendimtar me dialogun me Serbinë për ta arritur marrëveshjen ligjërish obligative për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe

Serbisë. E nderuar kancelare, në shërbim të këtij procesi unë mendoj se Bashkimi Evropian duhet të vazhdojë ta luajë rolin e vet ndërmjetësues edhe gjatë fazës përfundimtare, mirëpo unë e mirëpres një rol aktiv dhe ndihmues tuajin në këtë proces për arsye se ju gëzoni respektin dhe besimin e plotë në Kosovë e në Serbi. Jeni shpresa e vetme për Ballkanin Perëndimor që të lëvizë më shpejt drejt perspektivës evropiane", ka deklaruar Thaçi. Sipas tij, faza përfundimtare e dialogut nuk do të jetë fare e lehtë



elit në dialogun Kosovë - Serbi



as për Kosovën e as për Serbinë mirëpo, siç ka theksuar Thaçi, nuk ka rrugë tjetër për të ecur përpara. "E di që faza përfundimtare e dialogut nuk do të jetë fare e lehtë as për Kosovën, në të njëjtën kohë as për Serbinë. Mirëpo, nuk kanë rrugë tjetër për të ecur përpara Kosova e Serbia përpos dialogut dhe marrëveshjes. Bashkë duhet ta gjejmë mënyrën që nëpërmjet dialogut të arrijmë një marrëveshje përfundimtare që do t'i japë fund trashëgimisë tragjike historike, si dhe do ta hapë epokën e paqes

dhe pajtimit në mes të popujve tanë. Marrëveshja ligjërish obligative në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë me njohje reciproke, sepse vetëm kjo mundëson heqjen e të gjitha pengesave për anëtarësimin edhe të Kosovës, por edhe të Serbisë në Bashkimin Evropian", është shprehur Thaçi, duke shtuar se procesi i Berlinit i lansuar nga kancelarja Merkel në vitin 2014 ka dhënë kontribut të matshëm në përmirësim të fuqizimit të perspektivës evropiane për gjashtë shtetet e Ballkanit

Perëndimor. "Shpresoj se Samiti i Sofjes do të jetë edhe një hap tjetër shpresëdhënës dhe konkret për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor", ka theksuar ai. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova moderne, e konsoliduar si shtet, me vizion të qartë për t'u integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO, është rasti më i suksesshëm i intervenimit dhe i bashkësisë ndërkombëtare në botë, ku Gjermani ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol udhëheqës. "Prandaj ne ndihemi të obliguar që si shtet i ri ta japim kontributin tonë modest në shërbim të forcimit të paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka vlerësuar se takimi me kancelaren Merkel është një tjetër rikonfirmim i marrëdhënieve miqësore në mes të Kosovës dhe Gjermanisë. "Ju falënderoj personalisht juve kancelarja Merkel dhe popullin e mrekullueshëm gjerman për ndihmën dhënë Kosovës në procesin e shtetndërtimit. Kosova dhe qytetarët e saj janë gjithmonë mirënjohës. Jemi shumë të interesuar për sjelljen e investitorëve gjermanë në Kosovë dhe natyrisht të ketë edhe rritje të bashkëpunimit tregtar", ka thënë presidenti Thaçi.



Shpend Ahmeti zgjedhet kryetar i PSD-së

Kuvendi i jashtëzakonshëm i Partisë Socialdemokrate (PSD), e cila deri më sot është drejtuar nga Kaqusha Jashari, të mërkurën zgjodhi me shumicë votash kryetar Shpend Ahmetin, nënkryetar Visar Ymerin dhe sekretare të përgjithshme Aida Dërgutin

**EPOKA
ERE**

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 9 MAJ - Kuvendi i jashtëzakonshëm i Partisë Socialdemokrate (PSD) ka zgjedhur të mërkurën Shpend Ahmetin kryetar të kësaj partie. Nënkryetar i saj është zgjedhur Visar Ymeri, ndërsa sekretare e përgjithshme Aida Dërguti. Në këtë mbledhje u zgjodh edhe Këshilli Drejtues i partisë si dhe është marrë vendimi që PSD-ja të tërhiqet nga koalicioni i lidhur me PAN-in para zgjedhjeve të fundit parlamentare.

Zgjedhja e kryetarit të Prishtinës në krye të PSD-së është bërë larg syrit të medieve.

Partisë Socialdemokrate të Kosovës i janë bashkuar 12 deputetë që kishin fituar ulëset në Kuvendin e Kosovës duke garuar nën flamurin e Lëvizjes Vetëvendosje. Këta deputetë kishin dhënë dorëheqje nga LV-ja muaj më parë.

Kryetari i sapozgjedhur i PSD-së, Shpend Ahmeti, në fjalimin e tij tha se duhet punuar për instalimin e vlerave evropiane në Kosovë. Ahmeti, duke folur në ceremoninë pas Kuvendit të partisë, ka thënë se Kosova duhet të punojë që ta instalojë

Evropën këtu. "Nuk është përzgjedhur rastësisht data 9 maj, Dita e Evropës, që çuditërisht në Kosovë është ditë pushimi. Ne fjalorin e kemi gabim: shkuarja në Evropë, shkuarja në Bruksel. Ne duhet ta instalojmë Evropën në Kosovë. Ne nuk do të shkojmë të gjithë të jetojmë në Evropë. Ne duam që standardet e BE-së t'i kemi në Kosovë", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se duhet "luftuar" për socialdemokracinë në vendin tonë.

Nënkryetari i zgjedhur i Partisë Social Demokrate, Visar Ymeri, ka thënë se kjo parti do të angazhohet për barazi dhe mirëqenie të qytetarëve. "Duhet të jemi demokratë për së brendshmi dhe të insistojmë që kjo republikë dhe kjo ekonomi të jetë në shërbim të shoqërisë. Këto janë gjërat që neve na bëjnë bashkë dhe këto janë gjërat që i duhen më së shumti Republikës së Kosovës. Socialdemokracia është reformë e sistemit politik të korrupsionit dhe ekonomi që punon për të gjithë, e jo vetëm për ata që kanë", ka thënë Ymeri, i cili për tre vjet ka qenë kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, por u largua nga ajo pas përplasjeve të brendshme.



Haradinaj: Ilir Konushevcu e Hazir Mala ishin planifikues të rrugës për liri

"Epoka e re"

TIRANË, 9 MAJ - "Fakti se mblidhemi në Tiranë në një akademi për t'i përkujtuar Ilir Konushevcin e Hazir Malën, na tregon se bëhet fjalë për një situatë të veçantë, për një rrethanë të veçantë, për njerëz të veçantë. Nuk janë të vetmit këta dy luftëtarë shqiptarë andej e këndej kufirit që kanë qenë dhe kanë luftuar bashkë, por është rënia e tyre, një rënie e veçantë, pra ata ranë duke afuar luftën aty ku ndodhte". Kështu ka deklaruar të mërkurën kryeministri Ramush Haradinaj në akademinë përkujtimore me rastin e 20-vjetorit të rënies së dëshmorëve të kombit, gjeneralmajor Ilir Konushevcu dhe dr. Hazir Mala, që është mbajtur në Tiranë nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës.

Të pranishëm në këtë ngjarje ishin drejtues të lartë të institucioneve të Kosovës dhe Shqipërisë, kryetari i Kuvendit

të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ministra, zëvendësministra, pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, ambasadori i Kosovës në Shqipëri, Sylë Ukshini, familjarë e bashkëluftëtarë të dëshmorëve Ilir Konushevcu e Hazir Mala dhe qytetarë nga Kosova e Shqipëria. "Iliri ishte një djalë shqiptar, i cili vizionin për liri nuk e kishte kopje të askujt, por të veten, të familjes dhe e kishte të thellë, jo sipërfaqësor. Ky vizion për liri buronte nga ai. E kishte kultivuar dhe ndërtuar deri në veprime që na çojnë te liria. Dikush që lirinë e ka ndjerë, e ka pasur në vete, e ka përcaktuar si qëllim të tij por, jo vetëm kaq. Ai ishte krijues i shumë veprimeve deri te liria", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Më tej, Haradinaj ka thënë se Iliri ishte idealist i lirisë, i cili pastaj kishte kaluar në etapën tjetër, planifikim dhe zbatim. "Iliri, përveç përcaktimit për liri,



ishte planifikues i të gjithë rrugës sonë deri te liria, rrugë e përpjekjeve dhe veprimeve luftarake, e organizimeve luftarake, politike, e njerëzore, njëkohësisht e zbatimit. Pjesa e zbatimit ishte jo e lehtë për shkak se, për t'u bërë bashkë të gjithë këta komponentë deri te liria, nuk ishte projekt i thjeshtë", ka thënë Haradinaj, duke theksuar se në këto përpjekje të Ilirit më së paku ishte e pranishme frika nga vdekja. Më pas kryeministri ka thënë se gjatë takimeve me Ilirin ka hetuar tek ai një guxim për të mos parë pamje të pjesshme, por të shohë totalin dhe të mos e lejojë veten që të bëhet pjesë e organizimeve më të ngushta. Kryeministri Haradinaj ka folur

edhe për takimin e tij me Hazir Malën, duke thënë se Haziri nuk ishte vetëm një djalë që nga emocionet iu bashkua UÇK-së, por ishte një intelektual, një djalë i një familje intelektuale. "Familja e Hazir Malës dhe vetë Haziri ishte bazë e fuqishme, e respektuar për UÇK-në. Nuk ka mision më të mirë, nuk ka qëllim më të drejtë dhe vlerë më sublimë sesa ecja deri në liri për popullin tënd, për fëmijët, nënat, pleqtë, për të gjithë ata që ishin të pambrojtur në Kosovë, për të gjithë ata që edhe bota më e civilizuar u detyrua të lëvizë", ka thënë Haradinaj.

Para të pranishmëve kryeministri Haradinaj ka thënë se me angazhimin e NATO-s e gjithë bota e civilizuar u angazhua të

veprojë në rrugën në të cilën ishin Iliri e Haziri. "Rruga jonë deri në lirinë e plotë nuk është e lehtë, nuk ka qenë as atëherë e thjeshtë, edhe atëherë ka pasur mjegull, do të ketë mjegull dhe tash e në të ardhmen, por në çastet kyçe do të vërtetohet se kush sa ka bërë në rrugën e plotë të lirisë. Kontributi në rrugën për liri nuk do t'i humbë askujt kurrë, ndërkaq të tjerët do t'i harrojnë edhe historia edhe koha", ka thënë Haradinaj.

Përkritazi me këtë, kryeministri ka pohuar se Evropa tani duhet t'i hapë negociatat për Shqipërinë, ndërsa popullit të Kosovës duhet t'ia japë liberalizimin e vizave. "Si ka mundësi Evropa të jetë e lirë nëse një popull, më i vjetri në këtë kontinent nuk është i lirë", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se do të punojnë për ato vlera për të cilat kanë vdekur njerëzit tanë më të mirë.

Në emër të institucioneve të Shqipërisë, për figurën dhe veprën e lavdishme të dëshmorëve të kombit, Ilir Konushevcu e Hazir Mala, ka folur zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, i cili ka thënë se askush nuk i ndalë që dëshmorët e Kosovës t'i konsiderojnë dëshmorë të Shqipërisë dhe anasjelltas.

Në emër të bashkëluftëtarëve ka folur ish-komandanti i Zonës Operative të Llapit, Rustem Mustafa, në emër të shoqatave të dala nga lufta Xhavit Jashari, ndërsa të pranishmit në emër të familjeve Konushevcu dhe Mala i ka falënderuar Arton Konushevcin, vëllai i dëshmorit Ilir Konushevcu.



Edita Tahiri: Fëmijët shqiptarë përjetuan gjenocidin serb gjatë luftës

STAMBOLL, 9 MAJ - Ish-ministria për dialog dhe kryenegociatore, Edita Tahiri, mori pjesë në Konferencën shkencore me temë "Ndikimet e luftës te fëmijët", e cila u mbajt në Stamboll, më 6 dhe 7 maj, me pjesëmarrjen e botës akademike nga Turqia, Algjeria, Libija, Iraku, Libani, Maroko dhe vendet e tjera. Në këtë konferencë Edita Tahiri ka paraqitur kumtesën me titull "Fëmijët dhe lufta e Kosovës: mësimet e nxjerra".

Qëllimi i kësaj kumtese ishte të ofrojë një pasqyrë të ndikimeve të luftës së Kosovës ndaj fëmijëve, me fokus të veçantë në rolin e strategjive që mund të ndikojnë në zbutjen e efekteve dëmtuese të luftës, gjatë dhjetë vjetëve të okupimit dhe luftës në Kosovë, 1989-1999. "Çdo luftë ka ndikim të tmerrshëm tek fëmijët si dhe në gjithë popullsinë.

Megjithatë, fëmijët janë më të prekur nga luftërat, pasi trajektorja e tyre normale e jetës merr shqetësime duke shkaktuar pasoja afatgjata në jetën e tyre të ardhshme. Bilanci tragjik i çdo lufte tregon se shumë fëmijë janë vrarë, plagosur dhe abuzuar në mënyra më të tmerrshme", ka thënë Tahiri.

Ajo ka theksuar se deri më sot ka pasur shumë pak përpjekje shkencore për t'i parë përvojat e luftës të fëmijëve të lidhur me mjediset ku ata jetonin dhe rolin e mjedisit në zbutjen e efekteve të luftës. "Në lidhje me ndikimet e luftës tek fëmijët, rasti i luftës për pavarësinë e Kosovës paraqet një rast specifik studimi në të cilën mund të shihet se si vetorganizimi i institucioneve shtetërore në rrethana okupimi nga ana e rezistencës paqësore ka mundësuar që edhe në



rrethana okupimi të krijohet një mjedis institucional në shërbim të ruajtjes së shëndetit dhe shkollimit të fëmijëve", është shprehur Tahiri.

Ajo ka thënë se në rastin e luftës në Kosovë, fëmijët shqiptarë, që

përbëjnë gjysmën e popullsisë së Kosovës, kanë përjetuar spastrime etnike, gjenocid dhe apatheid gjatë dhjetë vjetëve, 1989-1999, nën okupimin dhe luftërat e imponuara nga Serbia. "Si e gjithë populli shqiptar, edhe

fëmijët u janë ekspozuar të gjitha formave të brutalitetit të regjimit okupator serb. Fëmijët shqiptarë u vranë, u plagosën, humbën të dashurit e tyre, u bënë persona të zhdukur, iu mohuan të drejtat themelore të njeriut, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë dhe shërbimet e tjera sociale, vajzat u përduan, sulmet kimike masive u shkaktuan kundër fëmijëve të shkollës së mesme dhe përfunduan duke u bërë refugjatë", ka thënë Tahiri, duke shtuar se humbjet dhe shkatërrimet gjatë luftës në Kosovë ishin dramatike, me mbi 12 000 shqiptarë etnikë të vrarë, qindra mijëra të torturuar, më shumë se 20 000 gra të dhunuara, rreth 8 000 u zhdukën dhe rreth një milion të dëbuar me forcë nga Kosova gjatë luftës, ndërsa një gjysmë milion gjatë periudhës së okupimit.

Gjeneralmajori Orr përgëzon FSK-në për të arriturat

Komandanti i Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajori Timothy Orr, gjatë takimit që ka zhvilluar të mërkurën me ministrin e FSK-së, Rrustem Berisha dhe komandantin e kësaj force, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë se është i kënaqur me të arriturat e FSK-së

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 9 MAJ - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrustem Berisha, të mërkurën ka pritur në takim komandantin e Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajorin Timothy Orr. Me këtë rast, ministri Berisha ka vlerësuar lart bashkëpunimin ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Iowas, duke theksuar se sukseset e arritura të kësaj force janë meritë e këtij bashkëpunimi.

Berisha ka thënë se FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besuar i sigurisë në vend. Ai ka thënë se FSK-ja ka arritur sukses për integrimin e komuniteteve pakicë, në veçanti të komunitetit serb nga veriu i Kosovës. Berisha ka folur edhe për përfaqësimin gjinor në FSK, duke theksuar se nga marsi i këtij viti FSK-ja për herë të parë ka një femër me gradën e gjeneralit. Po ashtu, ministri Berisha ka vlerësuar lart pjesëmarrjen e pjesëtarëve të Gardës

Kombëtare të Iowas në ushtrimin fushor "Shqiponja 6", të cilët kanë dhënë kontributin e tyre të vlefshëm si në fazën e përgatitjes së ushtrimit, po ashtu edhe në atë të ekzekutimit të tij.

Ndërsa komandanti i Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajor Timothy Orr, ka përgëzuar drejtuesit e FSK-së për rezultatet e arritura, sidomos ka vlerësuar lart integrimin e komunitetit serb në FSK dhe rritjen e besueshmërisë në veri të vendit. Ai ka falënderuar ministrin Berisha për mundësinë e pjesëmarrjes në ushtrimin fushor "Shqiponja 6" të pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Iowas, duke thënë se pjesëmarrja në këtë aktivitet, përveç kontributit dhe rëndësisë së rritjes së ndjenjës së bashkëpunimit, është edhe një përvojë e re për ta për koordinim me partnerët në situata emergjente.

Po ashtu, të mërkurën komandanti i Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajor Timothy Orr, është pritur në takim edhe



nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Në këtë takim është biseduar për zhvillimet në FSK, për përgatitjet e planeve për transformim dhe sfidat aktuale që po has ky proces. Komandanti i FSK-së, Rrahman Rama, e ka njoftuar gjeneralin Orr për rrjedhat e ushtrimit fushor "Shqiponja 6", duke theksuar se për FSK-në është sukses që

për herë të parë ka një numër kaq të madh të shteteve pjesëmarrëse në këtë ushtrim. Rama e Orr kanë biseduar edhe për integrimin e suksesshëm të komuniteteve në FSK. Rama ka thënë se ka një tregim suksesi edhe me integrimin e komunitetit serb nga veriu i Kosovës. Po ashtu, ai e ka njoftuar gjeneralin Orr edhe me rezultatet e konferencës "FSK-

ja dhe partnerët". Kurse komandanti i Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajor Timothy Orr, ka thënë se ministri dhe komandanti i FSK-së kanë bërë gjërat e duhura në kohën e duhur. Sipas tij, ky është shtegu i suksesit që duhet ndjekur FSK-ja edhe në të ardhmen. Orr ka thënë se në Kosovë ndihet si në shtëpinë e vet.

Goranëve u premtohet krijimi i komunës

Kryeministri Ramush Haradinaj para banorëve të Brodit të Dragashit ka pohuar se krijimi i një komune të re, asaj të Gorës, nuk është humbje për shqiptarët. "Jam përkrahës i një komune në Gorë, që jeta të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme", ka deklaruar Haradinaj

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

DRAGASH, 9 MAJ - "Republika e Kosovës ka Kushtetutën e saj më të avancuar dhe më moderne, e cila qartë përcakton të drejtat e secilit komunitet që jeton në Kosovë, edhe të komunitetit goran. Si kryeministër i vendit, përtej asaj që është shkruar, jam angazhuar që Qeveria që drejtoj të jetë e përfaqësuar nga secili komunitet, që ata të jenë të ngarkuar me detyra për t'i realizuar kërkesat dhe përmirësuar jetën e secilit qytetar", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj



në shënimin e Ditës së Goranëve në Brod të Dragashit.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se simbolika e kësaj feste është e ngjashme me plot rajone të tjera të vendit. "Kemi biseduar për mënyrën e jetesës për temat se çfarë mund të bëjë Qeveria. Kjo është iniciativë e deputetit të nderuar Adem Hoxha, që është deputet goran në Kuvendin e

Kosovës. Kam ardhur këtu me propozimin e tij që të informohem për gjendjen dhe proceset këtu", ka thënë Haradinaj. I pari i Qeverisë para banorëve të Brodit të Dragashit ka pohuar se krijimi i një komune të re, asaj të Gorës, nuk është humbje për shqiptarët kudo që janë, as në Opojë, as në Prizren apo diku. "Përkundrazi, u mundëson

këtyre njerëzve të jetojnë dhe t'i kenë mundësitë për jetë. Jam përkrahës i një komune në Gorë që jeta të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme", ka deklaruar Haradinaj. Ndërkaq deputeti nga radhët e komunitetit goran, Adem Hoxha, e ka falënderuar kryeministrin për përkrahjen e vazhdueshme, kurse ka shpjeguar para të pran-

ishmëve mënyrën e festimit të kësaj dite. Dita e Goranëve është festë që simbolizonin bashkimin, harmoninë dhe mirëqenien. Në këtë manifestim u tha se kjo festë është dëshmi e përpjekjeve të përbashkëta, për ta ndërtuar shtetin e Kosovës. Gjatë vizitës në Brod të Dragashit kryeministri Haradinaj ka bashkëbiseduar me qytetarë të shumtë të kësaj ane.

Qeveria e Kuvajtit do ta ndihmojë Kosovën në punësim



Ministrja e Çështjeve Sociale dhe e Punës së Kuvajtit, Hind Sabeeh Barak Al-Sabeeh, gjatë takimit me homologun e saj nga Kosova, Skender Reçica, ka thënë se Kuvajti ka nevojë për fuqi punëtore në disa profile dhe me këtë rast ka shprehur gatishmërinë që një marrëveshje e tillë të arrihet sa më parë për punësim të qytetarëve të Kosovës në shtetin e Kuvajtit

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, po qëndron në një vizitë zyrtare në shtetin e Kuvajtit, me ftesë të homologes së tij. Të mërkurën ministri Reçica ka takuar ministren e Çështjeve Sociale dhe të Punës, njëherësh ministre për Çështje Ekonomike,

Hind Sabeeh Barak Al-Sabeeh. I pari i MPMS-së e ka falënderuar homologen e vet për pritjen si dhe për përkrahjen që Kuvajti po i jep Kosovës. Gjithashtu, e ka njoftuar rreth gjendjes socio-ekonomike në Kosovë dhe përpjekjeve që po bën Qeveria e Republikës së Kosovës, respek-

tivisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për uljen e papunësisë dhe ngritjen e mirëqenies sociale për qytetarët e saj.

Në kuadër të kësaj, Reçica ka theksuar përkushtimin e tij dhe të dikasterit që drejton për arritjen e marrëveshjeve për punësim

sezonal në shtete të BE-së dhe më gjerë dhe në këtë rast, edhe me shtetin e Kuvajtit. Ai ka thënë se Kosova ka kuadro të përgatitura dhe të certifikuara, të gatshme për tregun e punës jashtë vendit.

Ministrja Hind Sabeeh Barak Al-Sabeeh ka thënë se Kuvajti ka nevojë për fuqi punëtore në disa profile, me këtë rast ka shprehur gatishmërinë e plotë që një marrëveshje e tillë të arrihet sa më parë për punësim të qytetarëve të Kosovës në shtetin e Kuvajtit.

Temë diskutimi ishte edhe bashkëpunimi për ngritjen e

mirëqenies së disa kategorive në Kosovë si, personave të moshuar, fëmijëve, si dhe grupeve të cënueshme, ku ministri Reçica ka kërkuar ndihmën e Qeverisë së Kuvajtit për ndërtimin e disa qendrave për persona të moshuar, për banim social si dhe për fëmijë pa përkujdesje familjare.

Ministrja Hind Sabeeh Barak Al-Sabeeh ka ofruar mbështetjen dhe gatishmërinë e Qeverisë së Kuvajtit për ta ndihmuar Kosovën në këto çështje dhe janë pajtuar bashkërisht që këto projekte të konkretizohen sa më parë.

Pika doganore do të zhvendoset në Gllloboçicë

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Ministri i Infrastruktūrës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se pas ndalimit të qarkullimit rrugor në N 2, segmenti Kaçanik - Hani i Elezit, në koordinim të plotë me ministrinë e linjës, Ministrinë e Financave, ka marrë vendim të zhvendoset përkohësisht pika doganore në pikën kufitare Gllloboçicë. Ky vendim, sipas Lekajt, ka ardhur me qëllim që mos të krijohen kolona dhe pritje të gjata për transportuesit e mallrave dhe qytetarëve. "Sot kam biseduar me ministrin për Transport dhe Lidhje të Maqedonisë, Goran Sugareski, me të cilin mbeti e

hapur mundësia e një takimi për të qenë sa më të koordinuar në të dyja anët e kufirit", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook". Po ashtu, ministri Lekaj ka treguar se për këtë çështje ka biseduar me ambasadorët, atë të Maqedonisë në Kosovë dhe të Kosovës në Maqedoni, për të qenë në koordinim të plotë të dyja shtetet që kjo situatë e përkohshme të menaxhohet sa më mirë.

Më tej, Lekaj ka theksuar se për çdo zhvillim do të jenë bashkë në krye të detyrës me të gjitha kapacitetet e tyre ministrore që të tejkalohet kjo situatë.



Beqaj: Iowa po jep kontribut për zhvillimin ekonomik të Kosovës



PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, të mërkurën ka takuar delegacionin e Iowas që po qëndron këto ditë në vendin tonë. Në një takim të organizuar nga Oda

Ekonomike Amerikane në Kosovë, ministri Beqaj ka bashkëbiseduar me delegacionin nga Iowa për mundësitë e bashkëpunimit në shumë fusha në mes të Kosovës dhe shtetit të Iowas.

Ministri Beqaj e ka falënderuar shtetin e Iowas për kontributin e dhënë në vazhdimësi për Kosovë dhe ka shprehur interesimin e tij dhe të Kosovës për fuqizim dhe shtim të bashkëpunimit në të ardhmen.

"Shteti i Iowas po kontribuon shumë për zhvillimin ekonomik dhe për rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Për këtë e falënderova dhe u pajtuam për fuqizim dhe shtim të bashkëpunimit", ka deklaruar

ministri Beqaj pas këtij takimit. Delegacioni i shtetit të Iowas po qëndron për një vizitë në Kosovë, gjatë së cilës ky delegacion ka takuar udhëheqësit më të lartë shtetërorë dhe institucionalë.

Kërkohet zbatimi i vendimit të MTI-së për qumështin

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 MAJ - Dogana e Kosovës ka reaguar ndaj rrjetit të organizatave joqeveritare "Avonet", i cili ka kritikuar Doganën për moszbatimin e vendimit të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani, lidhur me masat mbrojtëse për qumështin e importuar nga Bosnja. "Dogana e Kosovës është në pritje të vendimit sipas procedurave ligjore që kërkohen me kodin doganor dhe të akcizave, gjegjësisht nenin 9.1 të kodit doganor, ku për zbatimin e vendimit të MTI-së për masat mbrojtëse në import kërkohet që vendimi të merret nga Qeveria e Kosovës. Për këtë Dogana e ka

njoftuar MTI-në para datës 23 prill. Dogana deri sot nuk ka pranuar asnjë vendim sipas procedurave ligjore që kërkohen për zbatim në importin e qumështit nga Bosnja, ku vendoset taksa doganore prej 17 përqindësh në vlerë", është thënë në reagimin e Doganës së Kosovës. Gjithashtu, Dogana ka njoftuar se është duke i zbatuar disa vendime të MTI-së për vendosjen e masës së përkohshme të importit të materialit ndërtimor nga argjila, si dhe vendimin për vendosjen e masave në importin e miellit nga Serbia. "Dogana është institucion i zbatimit të ligjit dhe çdo vendim të Qeverisë e ka obligim ligjor ta zbatojë", është thënë në reagimin e



Doganës. Rrjeti i organizatave joqeveritare "Avonet" ka vlerësuar se Dogana e Kosovës nuk është duke zbatuar vendimin e ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, i cili ka marrë masa mbrojtëse për

qumështin duke u bazuar në kompetencat ligjore. Ky rrjet përmes një reagimi dërguar medieve ka shprehur shqetësim të thellë lidhur me këtë çështje. "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim të

vazhdimin të mbrojtjes së prodhimit vendor, ka vënë si prioritet që t'i mbështesë prodhimet vendore, por nga ana tjetër Dogana e Kosovës nuk është duke e zbatuar këtë vendim, gjë e cila është në kundërshtim të zbatimeve dhe vendimeve që merren nga institucionet e Republikës së Kosovës. Dogana e Kosovës duhet t'i respektojë vendimet dhe t'i zbatojë të gjitha vendimet që janë në harmoni ligjore dhe që janë të bazuara në ligjet e Republikës së Kosovës. Moszbatimi i vendimeve krijon dyshime që në këtë institucion, pra në Doganën e Kosovës, ka grupe të interesit të cilat pengojnë mbështetjen e prodhimeve vendore", thuhet në reagimin e rrjetit të organizatave joqeveritare "Avonet".

Dogana konfiskon 48 000 copë cigare pa banderola

Prishtinë, 9 maj (ER) - Njësitë e Doganës gjatë këtyre ditëve kanë konfiskuar në disa raste të ndara sasi të konsiderueshme të duhanit, më saktësisht 48

000 copë cigare. Sipas një njoftimi të Doganës, në aksin rrugor, drejtimi Lipjan - Magurë, është ndaluar një automjet me targa të Kosovës në të cilin, pas kon-

trollit, rezultoi me sasi të konsiderueshme të duhanit pa banderola të cilat ishin të kontrabanduara. Edhe në një aksion tjetër në qytetin e Pejës janë gjetur

cigare pa banderola të cilat janë konfiskuar. Edhe në një aksion tjetër në Prishtinë janë kapur sasi të konsiderueshme të duhanit pa banderola në disa lokacione.

"Në total sasia e konfiskuar arrin në 48 000 copë cigare, kurse kundër personave janë duke u iniciuar procedurat kundërvajtësve", është thënë në njoftimin e Doganës.

Më 5 qershor organizohet aksioni 'Ta pastrojmë Kosovën'

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Për nder të 5 Qershorit, Ditës Botërore të Mjedisit, Organizata "Let's Do It Kosova" do të organizojë aksion të madh të pastrimit "Ta pastrojmë Kosovën" në të gjitha komunat e Kosovës.

Aksioni i pastrimit i organizuar nga "Let's Do It Kosova" do të mbahet në kuadër të aktiviteteve të parapara nga një këshill i përbashkët që përbëhet prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe OJQ-ve mjedisore. "Tashmë, Let's Do It Kosova ka filluar organizimin e këtij aksioni, i cili do të realizohet në bashkëpunim me komunat e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, KMDK-në OJQ e grupe vullnetarësh nga e tërë Kosova, kompani të pastrimit të mbeturinave dhe kompani të

shumta private që do t'i ofrojnë makineritë e tyre për largimin e mbeturinave gjatë aksionit. Ndërsa kompanitë private si 'Scampa', 'Meridian' e 'Dita' do të ofrojnë mjete logjistike", është thënë në njoftimin e "Let's Do It Kosova".

Kjo organizatë u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që më 5 qershor të dalin në aksione për largimin e mbeturinave nga deponitë ilegale, në mënyrë që të gjithë së bashku të japin kontribut për përmirësimin e imazhit të vendit. 5 qershori u caktua si Dita Botërore e Mjedisit në vitin 1972 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, ndërsa qëllimi i kësaj dite është të nxisë aktivitete dhe aksione për arritjen e ndryshimeve pozitive për mbrojtje të mjedisit.



Përfundon asfaltimi i rrugës Junik - Nivokaz

JUNIK, 9 MAJ (ER) - Ka përfunduar asfaltimi i rrugës që lidh Komunën e Junikut me fshatin Nivokaz, një projekt mjaft domethënës që ndikon në mirëqenën e të dy vendbanimeve.

Kjo rrugë ka përfunduar sipas afatit kohor të paraparë. Në projekt të kësaj rruge janë përfshirë shenjëzimi në rrugë dhe shenjëzimi vertikal me të gjitha shenjat e nevojshme për një komunikacion të rregullt.



Përfundojnë procedurat për binjakëzim mes Gjakovës dhe qytetit Fort Dodge

GJAKOVË, 9 MAJ (ER) - Qyteti i Gjakovës ka përfunduar të mërkurën procedurat e binjakëzimit me qytetin Fort Dodge të Iowas. Delegacioni i qytetit Fort Dodge është takuar me kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ku u informua më shumë rreth zhvillimit të jetës në këtë qytet. "Jemi jashtëzakonisht të lumtur që miqtë tanë sot janë këtu me ne dhe po përfundojmë

një proces të nisur tashmë. Do të kemi bashkëpunim në të gjitha fushat e jetës, në art, kulturë, zhvillim të biznesit", ka thënë kryetari Gjini.

Ndërkaq Dawn Larson, specialist i zhvillimit ekonomik, ka thënë se janë shumë të lumtur që do t'i shkëmbejnë përvojat e tyre në shumë fusha me këtë komunë. "Ne porsa zhvilluam një takim në të cilin u njohëm më shumë me

funksionimin e qytetit. Do të kemi mundësi që gjatë qëndrimit tonë këtu të shohim më për së afërmi edhe zhvillimin e bizneseve, do t'i shkëmbejmë edhe përvojat e universiteteve, do ta shohim zhvillimin e jetës kulturore dhe historinë e qytetit tuaj", ka deklaruar Larson. Delegacioni i qytetit të Fort Dodge do të qëndrojë në qytetin e Gjakovës deri të premten.

Komuna e Malishevës mbulon shpenzimet për shërbimet e varrimit

MALISHEVË, 9 MAJ (ER) - Duke u bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal të Malishevës, të datës 4 prill të këtij viti, kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj dhe kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Malishevë, Xhevat Kryeziu, kanë nënshkruar marrëveshjen për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrit të personave të vdekur të cilët varrosen në territorin e



Malishevës. Sipas marrëveshjes, Këshilli i Bashkësisë Islame në Malishevë obligohet t'i kryejë shërbimet e varrimit, të cilat

mbulohen me mjete buxhetore të Komunës së Malishevës, ku përfshihet regjistrimi i rastit në librin amëz të të vdekurve, hapja e varrit, sigurimi i mjeteve të tjera për varrin dhe kufomën, me kosto të përgjithshme prej 200 eurosh.

Komuna e Malishevës edhe vitin e kaluar i ka mbuluar shpenzimet për shërbimet e varrimit.

Reshitaj i bashkohet aktivitetit të mbjelljes së drunjve në Suharekë

SUHAREKË, 9 MAJ (ER) - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, të mërkurën iu bashkua aktiviteteve të organizatës rinore "Kuvendi i të rinjve të Suharekës", me rastin e Ditës së Evropës - 9 maji. Me këtë rast ministria Reshitaj, së bashku me kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, e shumë vullnetarë të rinj mbollën drunj dekorativë në oborrin e Komunës së Suharekës, tek parku i qytetit dhe në fshatin Sellagrazhdë, si dhe rregulluan pjesë të gielbra në këtë qytet. Gjatë këtyre aktiviteteve ministria Reshitaj ka përgëzuar të rinjtë për vullnetin dhe punën e tyre



për mbrojtjen dhe kujdesin që kanë për mjedisin. Ajo ka thënë se duke mbjellë drunj dhe duke u

kujdesur për zonat e gielbra, mbjellim të ardhmen e vendit tonë brenda Evropës.

Epopeja e Grykës së Llapushnikut, sinonim i lavdisë, krenarisë dhe qëndresës së UÇK-së



Shkruan: Ferat SHALA

Beteja e Grykës së Llapushnikut është një ndër betejat më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në luftë kundër forcave ushtarake e policore serbe. Sot shënohet 20-vjetori i Epopesë së Grykës së Llapushnikut, një ndër betejat më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në luftë kundër forcave ushtarake e policore serbe. Duke kujtuar këtë betejë lavdie kthejmë kujtesën tonë historike 20 vjet më parë, kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës, pas disa aksioneve të suksesshme guerile, filloi ta ndërrojë formën, mënyrën dhe taktikën e luftës së saj për liri. Nga lufta guerile dhe aksionet e shpejta dhe të befasishme, kaloi në luftë frontale, duke e mbyllur për qarkullim Grykën e Llapushnikut dhe duke u

pozicionuar përballë forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe. Kjo ngjarje shënon një datë shumë të rëndësishme në zhvillimin dhe organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila nga organizimi gueril po kalonte në një organizim më të lartë ushtarak, e gatshme të përballej edhe me beteja frontale dhe me rezistencë ndaj tërë makinerisë ushtarake-policore serbe. Zënia e Grykës dhe zmbropsja e forcave serbe tregonte se UÇK-ja kishte kaluar në një fazë të re të mobilizimit e konsolidimit të radhëve dhe kishte forcë jo vetëm për ta sulmuar armikun nëpër prita me aksione guerile, por edhe për të vendosur barrikada lufte, me qëllim për t'i vënë në kontroll zonat e çliruara.

Betejës së Llapushnikut i paraprijnë disa ditë lufte të pandërprera të njësiteve të UÇK-së. Këto luftime u zhvilluan përgjatë gjithë muajit prill dhe në fillimmuajin maj 1998. Gjatë kësaj periudhe kohore u zhvilluan luftime dhe beteja të pandërprera në fshatrat Gjergjaj (Gjergjicë), Balincë, Arllat e Negrovci, kryesisht

përgjatë magjistrales Prishtinë-Pejë.

Bartës i betejave dhe luftimeve ishte njësitë i UÇK-së, "Pëllumbi", i mbështetur dhe ndihmuar edhe nga njësitet "Guri", "Lumi", "Çeliku" dhe njësitet e tjera të UÇK-së dhe vullnetarë të tjerë nga Drenica dhe më gjerë.

Këto beteja atëkohë konsideroheshin si një nga goditjet më të fuqishme dhe më të organizuara të njësiteve të UÇK-së kundër forcave serbe duke iu shkaktuar atyre dëme të konsiderueshme në mjete motorike të luftës dhe në njerëz.

Thyerja vendimtare e forcave serbe ndodhi më 9 maj 1998, me mbylljen për qarkullim të aksit rrugor Prishtinë - Pejë. Njësitë "Pëllumbi", në koordinim me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, merr vendimin për mbylljen e Grykës së Llapushnikut dhe me ndihmën e njësiteve të tjera kishte koordinuar planin operacional për zënien e grykës dhe pozicionimin e forcave të UÇK-së. Kjo ngjarje njëherësh ishte edhe fillimi i krijimit të zonave të lira të kontrolluara nga UÇK-ja edhe në zona të

tjera të Kosovës si në Malishevë dhe Dukagjin. Kjo situatë e krijuar pas zënies së Grykës së Llapushnikut ofroi mundësi shumë më të mira për komunikim, shtrirje, zhvillim, organizim e furnizim për të gjitha njësitet e tjera të UÇK-së. Ishte koha kur masivizimi dhe mobilizimi i UÇK-së arriti kulmin dhe rriti besimin e popullatës në njësitet e UÇK-së. Për tre muaj rresht Gryka e Llapushnikut do të bëhet arenë luftimesh dhe betejash, madje do të jetë edhe në qendër të vëmendjes edhe të medieve botërore dhe qendrave ndërkombëtare të vendosjes për fatin e Kosovës. Për tre muaj rresht luftëtarët e lirisë qëndruan sypatrembur dhe të pamposhtur përballë forcave ushtarake policore serbe që ishin qindra herë më të shumta edhe në numër edhe në teknikë dhe arsenal luftarak. Pëllumbat e lirisë treguan moral të lartë ushtarak, disiplinë dhe sakrificë të papërsëritshme, duke mbrojtur me sukses grykën dhe duke fituar një betejë të madhe. Në istikamet e Grykës së Llapushnikut krisën pushkët edhe të shumë trimave dhe dëshmorëve të kombit si Fehmi

dhe Xhevë Lladrovci, Rasim Kiçina, Imer Krasniqi, Ymer Alushni, Ali Zogaj e Sami Bogiqi, pastaj gjeneral Shaban Shala, Besim Halilaj dhe shumë luftëtarë të tjerë dhe vullnetarë nga Drenica dhe nga zonat e tjera të Kosovës. Sot kur shënojmë 20-vjetorin e kësaj beteje, gjithnjë e më shumë bindemi për lavdinë e saj dhe rëndësinë historike që kishte. Gjithnjë e më shumë bindemi për sakrificën, heroizmin dhe gatishmërinë e UÇK-së, për çlirimin e Kosovës. Bindemi se beteja e Llapushnikut ishte edhe një ngjarje që shënon kthesë të madhe edhe në planin diplomatik, duke i detyruar qendrat diplomatike botërore ta shikojnë seriozisht UÇK-në dhe ta vlerësojnë si partneren kryesore për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Andaj, sot kur kujtojmë me nder e respekt Epopenë e Grykës së Llapushnikut, kujtojmë dëshmorët e grykës dhe gjithë ata ushtarë që qëndruan dhe luftuan heroikisht në mbrojtje të grykës. Lavdi e përjetshme këtyre dëshmorëve! Respekt e nderim pafund për të gjithë luftëtarët e lirisë që morën pjesë në betejën e Grykës së Llapushnikut.

Përkujtohet 20-vjetori i betejës së Llapushnikut

DRENAS, 9 MAJ (ER) - Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të betejës së Llapushnikut, nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, të mërkurën në Llapushnik është mbajtur tubim përkujtimor. Në këtë tubim përkujtimor kanë marrë pjesë zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, familjarë dhe qytetarë të shumtë.

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, ka thënë se Beteja e Llapushnikut ia pati prishur planet Serbisë. "Beteja e Llapushnikut shpërtheu izolimin e Drenicës duke u ofruar mundësi viseve të tjera ta furnizojnë këtë pjesë të Kosovës me ushqime, armë e municione që duheshin në atë kohë. Beteja e Llapushnikut ka peshën e vet sepse ndërpreu lëvizjen e serbëve për t'i sulmuar forcat e UÇK-së në Dukagjin", ka thënë Limaj.

Ai ka thënë se Beteja e Llapushnikut nuk kishte lejuar që në Drenicë të përsëritet viti 1945. "Jemi në përvjetorin e Skënderbeut, heroit tonë kombëtar. Para çdo gjë tjetër, mos harroni e mos lejoni. Nuk ka asgjë më të shtrenjtë nga ajo që na bashkon, pra është flamuri dhe është gjuha jonë dhe heronjtë tanë me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe ai që ia mundësoi lirinë e Kosovës, Adem Jashari", ka shtuar Limaj.


Ndërsa kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se beteja e Llapushnikut bart kujtimet më të ndritura të kombit shqiptar. "Në ditën e përkujtimit të betejës së Llapushnikut shprehim respekt të thellë dhe përkulemi për të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët e kombit, të cilët kontribuan për çlirimin e vendit. Kujtojmë me respekt të gjithë pjesëmarrësit e kësaj qëndrese në Llapushnik, fshatrave përreth



si dhe çlirimtarët nga krejt Kosova, në veçanti nga komuna jonë, që u bënë simbol i qëndresës, duke e dhënë mesazhin se kjo tokë ka zot. Ky vend historie bart edhe kujtimet më të ndritura që nderu-

an kombin, për heronjtë e heroinat si Fehmi e Xhevë Lladrovci, Bekim Berisha, Imer Alushani dhe dhjetëra heronjve të tjerë, të cilët, me vullnet dhe përkushtim, rikonfirmuan se çlirimi nuk vjen pa sakrificë.

Lavdi heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të kombit!", ka thënë Lladrovci. Tubimi përkujtimor kushtuar betejës së Llapushnikut është përmblyllur me një program kulturor-artistik.



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

Parlamenti iranian djeg flamurin e ShBA-së

TEHERAN, 9 MAJ - Mbrëmjen e së martës, kur e gjithë bota priste mes tensionit dhe ankthit vendimin e presidenti të ShBA-së, Donald Trump, për ecurinë e marrëveshjes bërthamore me Iranian, në Parlamentin e Republikës Islamike

ishin mbledhur në një seancë urgjente.

Kur Trumpi njoftoi tërheqjen e ShBA-së nga pakti bërthamor, politikanët iranianë, deputetë e ministra, nisën të thërrisnin në kor "Vdekje Amerikës" dhe dogjën për

të parën herë në historinë e Parlamentit të Iranit, flamuj amerikanë.

Ligjvënësit, duke përfshirë një klerik shiit, mbajtën flamurin e ndezur në duar ndërsa kolegët iu bashkuan këngëve të tyre. Gjithashtu, ata

dogjën një copë letre që përfaqësonte marrëveshjen bërthamore.

Protesta e tensionuar erdhi pasi braktisja e ShBA-së tronditi bisedimet brenda Parlamentit për ecurinë e marrëveshjes së 2015-s, që u firmos nën udhëheqjen e Barack Obamës.



Vendimi i Trumpit shqetëson aleatët evropianë, zemëron Iranin

Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, liderët e të cilave kanë bërë përpjekje ta ndryshojnë mendjen e Trumpit, thanë se vendimi i Amerikës për tërheqje nga marrëveshja bërthamore është për keqardhje, porse ato do ta vazhdojnë respektimin e marrëveshjes



UASHINGTON, 9 MAJ - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e tërhoqi vendin e tij nga marrëveshja ndërkombëtare bërthamore me Iranin, duke rritur rrezikun e konfliktit në Lindjen e Mesme, duke shqetësuar aleatët evropianë dhe duke shkaktuar pasiguri për furnizimet globale me naftë.

Me marrëveshjen e vitit 2015, të nënshkruar nga Irani, Shtetet e Bashkuara, Rusia, Kina, Franca, Britania dhe Gjermania, Republika Islamike është pajtuar ta frenojë aktivitetin e saj bërthamor, në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare. Por, Trumpi tha se pakti nuk adreson një sërë çështjesh, përfshirë programin me raketa balistike të Iranit, aktivitetet e tij bërthamore pas vitit 2025 apo rolin e Teheranit në konfliktet në Jemen dhe Siri.

Irani ka zgjeruar ndikimin e tij politik dhe ushtarak në Lindjen e Mesme në vitet e fundit, duke brengosur thellë aleatët e ShBA-së: Izraelin dhe Arabinë Saudite. Pas njoftimit të Trumpit për tërheqje nga marrëveshja, Departamenti amerikan i Thesarit tha se sanksionet kundër Iranit do të rikthehen. Departamenti amerikan i Shtetit lëshoi, po ashtu një deklaratë, duke thënë se Uashingtoni do të punojë me aleatët "për të gjetur një zgjidhje

reale dhe gjithëpërfshirëse" për "kërcënimin iranian".

"Sanksionet do të hyjnë në fuqi të plotë dhe do ta rikujtojnë regjimin e Iranit për izolimin diplomatik dhe ekonomik që rezulton nga aktiviteti i tij i pamatur dhe malinj", tha Departamenti amerikan i Shtetit. "Kam urdhëruar Organizatën Bërthamore të Iranit që kurdo që të jetë e nevojshme, ta nisim pasurimin e uranimit, edhe më shumë se më parë", tha në përgjigje presidenti i Iranit, Hassan Rohani. "Kjo është një luftë psikologjike, ne nuk do të lejojmë që Trumpi të fitojë", shtoi Rohani.

Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar - liderët e të cilave kanë bërë përpjekje ta ndryshojnë mendjen e Trumpit - thanë se vendimi i Amerikës për tërheqje nga marrëveshja bërthamore është për "keqardhje", porse "ato do të vazhdojnë respektimin e marrëveshjes".

Ministria e Jashtme e Rusisë tha se është "thellësisht e zhgënjyer". Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, tha se BE-ja "është e vendosur ta ruajë marrëveshjen". "Presim që pjesa tjetër e bashkësisë ndërkombëtare të vazhdojë të bëjë pjesën e saj, për ta garantuar vazhdimin e zbatimit të marrëveshjes, për hir të sigurisë sonë kolektive", tha Mogherini.

Ish-presidenti amerikan Barack Obama, në kohën e të cilit është nënshkruar marrëveshja, tha se ajo ka funksionuar dhe se ka qenë në interes të ShBA-së.

"Largimi nga marrëveshja bërthamore ua kthen shpinën aleatëve më të afërt të Amerikës", tha Obama.

Zëdhënësi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara tha se Antonio Guterres është "thellësisht i shqetësuar" nga vendimi i Trumpit dhe se u bën thirrje nën-

shkruesve të tjerë t'i zbatojnë angazhimet e tyre.

Por, kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, tha se ai e mbështet plotësisht "tërheqjen e guximshme" të Trumpit nga një "marrëveshje katastrofike".

Arabia Saudite, rivalja rajonale e Iranit, tha se e mbështet dhe e mirëpret vendimin e Trumpit. Braktisja e paktit me Iranin është edhe një element i politikës së Trumpit "Amerika e para". Kjo politikë ka çuar në tërheqjen e ShBA-së nga Marrëveshja e Parisit

për Klimën, e ka afruar ShBA-në në një luftë tregtare me Kinën dhe e ka nxjerrë atë nga Marrëveshja Tregtare e Azi-Paqësorit.

Rikthimi i sanksioneve do ta bëjë shumë më të vështirë për Iranin ta shesë naftën e tij jashtë vendit ose ta përdorë sistemin ndërkombëtar bankar.

Irani është anëtar i tretë më i madh i Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës dhe prodhon rreth 3.8 milionë fuçi naftë në ditë ose rreth 4 për qind të furnizimit global.

Gina Haspel dëshmon në Senat

UASHINGTON, 9 MAJ - Gina Haspel, operative e Agjencisë Qendrore të Zbulimit dhe aktualisht zëvendësdrejtoresh e agjencisë, premtoi të mërkurën përpara ligjvënësve se nuk do ta ripërtërinte një program për marrjen në pyetje me metoda të ashpra të personave të ndaluar. Kjo çështje është kthyer në një pengesë të mundshme për konfirmimin e saj në postin e drejtueses së CIA-s.

Haspel ka dëshmuar para Komisionit të Senatit për Zbulimin në një seancë konfirmimi, e cila po përqendrohet te roli i saj në zbatimin dhe, ndoshta, përpjekjen

për ta mbajtur të fshehtë një program të agjencisë që përdorte metoda të ashpra për t'i marrë në pyetje personat e ndaluar. "Mund t'ju ofroj angazhimin tim personal, qartë dhe pa rezerva, se nën udhëheqjen time CIA nuk do të ripërtërijë një program të tillë të ndalimit dhe marrjes në pyetje", tha Haspel.

Në vitin 2002 Haspel mbikëqyri për një kohë të shkurtër një burg të fshehtë të CIA-s në Tajlandë, ku të paraburgosurit i nënshtroheshin teknikës së simulimit me mbytyje dhe teknikave të tjera të ashpra të marrjes në pyetje, të cilat shpesh

janë denoncuar si tortura. Ajo akuzohet edhe për hartimin e një dokumenti që kërkonte asgjësimin e 92 videokasetave të seancave ku ishin përdorur metoda të tilla.

Videokasetat u asgjësuan në vitin 2005, duke çuar në një hetim të Departamentit të Drejtësisë, i cili përfundoi pa akuza. CIA në mënyrë të përsëritur u është përgjigjur këtyre akuzave, duke pohuar se veprimet e Haspelit ishin të ligjshme dhe duke mbrojtur rolin e saj në pozicionin që kishte në atë kohë jashtë vendit si dhe rolin në asgjësimin e videokasetave.



Hapet Pavijoni i Kosovës në Festivalin e Kanës

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Për të shtatin vit me radhë Qendra Kinematografike e Kosovës vazhdon praninë në Festivalin e Kanës me pavijon në tregun më të madh të filmit në botë "Marche Du Film". Më 8 maj ka filluar edicioni i 71-të i Festivalit të Kanës dhe Kosova ka pavijonin e përbashkët me Shqipërinë i cili do të jetë i hapur deri më 18 maj në lokacionin e ri në "Village International" i cili është afër Greqisë, ShBA-së, Çekisë, Sllovakisë, Bullgarisë dhe vendeve të tjera të ish-Jugosllavisë. Qendra Kinematografike e Kosovës në treg do t'i promovojë filmat e fundit të Kosovës në kategori dhe faza të ndryshme të zhvillimit, gjithashtu do të ketë



shumë takime me partnerë ndërkombëtarë të kinematografisë, fonde filmi, përfaqësues të festivaleve të mëdha ndërkombëtare dhe producentë e distributorë të ndryshëm. Gjatë kësaj kohe, përveç përfaqësuesve nga QKK-ja, pavijonin e Kosovës pritet ta vizitojë edhe

ministri i Kulturës, Kujtim Gashi. Qendra Kinematografike e Kosovës së bashku me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë do të organizojnë një koktej rasti për të gjithë bashkëpunëtorët e fondeve të filmit, producentë, distributorë e përfaqësues të festivaleve.

67 projekte filmike kanë aplikuar në konkursin e QKK-së

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Në konkursin e Qendrës Kinematografike të Kosovës (QKK) për vitin 2018, afati i të cilit është mbyllur më 4 maj, kanë aplikuar 67 projekte filmike në kategori të ndryshme. 17 projekte filmike kanë aplikuar për film të metrazhit të gjatë artistik, për atë dokumentar të gjatë kanë aplikuar 9 projekte, kurse për film të metrazhit të gjatë artistik - koproduksion minor kanë aplikuar 6 projekte filmike dhe në atë të gjatë artistik - debutant kanë aplikuar 5 projekte. Për film të metrazhit të shkurtër artistik kanë aplikuar 17 projekte, kurse në atë



të shkurtër të animuar 4 projekte. Në konkursin për zhvillim të skenarit për film të metrazhit të gjatë kanë aplikuar 8 projekte filmike, ndërsa në atë për postproduksion për film të metrazhit të shkurtër një. Komisioni për verifikimin e dokumentacionit do t'i shqyrtojë të

gjitha projektet aplikuese nëse i plotësojnë kriteret e domosdoshme të konkursit. QKK-ja pastaj do ta emërojë jurinë vlerësuese dhe vendimi i saj pritet të jepet në fund të muajit qershor. Buxheti i QKK-së për këtë vit pritet të jetë rreth një milion euro.



Korbat dhe torbat

*Vazhdimisht vrapojnë dhe saora sulen
Kokrra kërkojnë kudo ku ato gjenden,
Shfrytëzojnë hutimin dhe pastaj ulen
Pak pranë presin e hëpërhë hamenden.*

*Vërdallë vërtiten dhe shuajnë etjen,
Ushqimi u mbaroi edhe enden kot fare,
Secili shpend, ai edhe gjeti fjetjen,
Dolën dromcat por dhe mbeti asaj are.*

*Secila sipërfaqe shihet dhe kudo korbat
Krrrokin këndej pari oh dhe gati sqepin,
U grumbulluan, së bashku dhe tani torbat
Derdhet driza, bërtitkan dhe çfarë qepin!*

*E paskan çarë thesin si dhe ankohej bujku
Mbeti kjo arë pa farë dhe n'treg shesin,
Shkuan shumë larg medet dhe ore qetë, ujku
Tash, talla tek ata prapë dhe mbushi thesin.*

*Shtiracak shkoni n'theqaf je ju dhe atje mos
T'mundohet u ngjani këtyre more dhe veç vlerin,
Shpeshherë u bëhet o deti djath' dhe kanë kos
Kur krihen, mburren me maskarenj dhe lanë' frerin!*

Janjevë, më 30 shtator 2008
Anton F. Gashi

Rreth 7 000 vizitorë për katër muaj vizituan Parkun Arkeologjik 'Ulpiana'

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Në kuadër të aktiviteteve të Ditës së Evropës, 9 maj dhe Vitit Evropian të Trashëgimisë Kulturore, në Zyrën e BE-së në Kosovë është organizuar konferenca "Trashëgimia kulturore në Kosovë - Parku Arkeologjik i Ulpianës", bashkëpunim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ambasadës së Francës në Kosovë. Në emër të MKRS-së në konferencë ka folur zëvendësministria e MKRS-së, Burbuqe Bakija-Deva, e cila ka shprehur edhe kënaqësinë që në kuadër të programit për shënimin e Ditës së Evropës në Kosovë flitet edhe për trashëgiminë kulturore të Kosovës. Duke folur për shënimin e kësaj dite, zëvendësministria Bakija-Deva ka thënë se ashtu si në vendet e tjera, edhe Kosova promovon pagën dhe unitetin, kësaj radhe edhe përmes trashëgimisë kul-



turore, duke e vlerësuar lart bashkëpunimin me Zyrën e BE-së dhe Ambasadën e Francës. Zëvendësministria Bakija-Deva ka shprehur gatishmërinë e MKRS-së për të bashkëpunuar edhe për të tjera iniciativa të përbashkëta për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore si pjesë integrale e

trashëgimisë evropiane dhe botërore. Ajo ka bërë me dije se në përputhje me planin e punës dhe buxhetin do të punohet në shumë lokalitete arkeologjike si në: Kalanë e Vuqakut, Kalanë e Prizrenit, të Novobërdës, Korishës, Keqekollës, Harilaqit, lokalitetin e Dersnikut dhe Parkun Arkeologjik "Ulpiana",

një nga lokalitetet me të vizituara vitet e fundit. "Vitin e kaluar Parku Arkeologjik ka pritur 23 000 vizitorë, kurse në periudhën 1 janar deri më 1 maj të këtij viti ka pritur 7 000 vizitorë", ka deklaruar zëvendësministria Bakija-Deva. Ajo ka bërë me dije se shumë shpejt MKRS-ja do t'i promovojë para opinionit publik

disa nga gjetjet shumë të rëndësishme të ekspeditave nga viti i kaluar. Bakija-Deva ka folur edhe për trashëgiminë arkitekturore, me ç'rast ka theksuar se Qendra Historike e Prizrenit mbetet prioritet. Ndërkaq ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka thënë se popujt evropianë i bashkon historia, kultura e trashëgimia. "Përveçse është viti evropian, në veçanti është viti i trashëgimisë kulturore. Për të na kujtuar që ne popujt evropianë kemi gjëra që na ndajnë, por kemi edhe gjëra që na bashkojnë. Gjërat që na bashkojnë janë historia, kultura e trashëgimia", është shprehur Chabert. Kurse përfaqësuesi i Zyrës së BE-së, Riccardo Serri, ka theksuar se diversiteti kulturor është baza e Bashkimit Evropian duke i dhënë një rol të veçantë trashëgimisë kulturore.

E DREJTA PËR TË PASUR TË DREJTË

(Ose përkthyesi si kuazi-autor i veprës së përkthyer)

VALBONA NATHANAILI

Në këtë artikull merret për analizë dukuria e mosreferimit të përkthyesit/përkthyesve të mëparshëm, nga përkthyesi i “ri” i së njëjtës vepër, në botimet në gjuhën shqipe. Shembujt e sjellë referojnë përvoja të huaja dhe shqiptare. Një kontribut i dytë është synimi për ta nxitur krijimin e normave të reja, që bien në domenin e etikës dhe kulturës të botimit, që e çojnë përkthyesin në një gjendje të re, atë të *kuazi*-autorit për veprën e përkthyer. Për këtë, ndër të tjera, propozohet që emri i përkthyesit të bëhet pjesë e kopertinës (një përvojë që zbatohet në shumë vende të tjera dhe herë pas here edhe në vendin tonë), të nxitet të shkruajë një parathënie, pjesë e së cilës të jetë edhe strategjia e ndjekur në përkthim, si dhe të referohen përkthyesit e mëparshëm në gjuhën shqipe të së njëjtës vepër të përkthyer, aty ku ekzistojnë.

I. Konsiderata të përgjithshme

Një nga teoricienët më të mirë të teorisë së përkthimit është André Lefevere (1945-1996). Lefevere i klasifikon përkthyesit në konservatorë dhe shpirtërorë. Përkthyesi konservator punon në nivelin e fjalës dhe të fjalisë,

ndërsa përkthyesi “shpirtëror” punon në nivelin e kulturës si e tërë dhe e vendos tekstin në funksion të kësaj kulture.¹ Me këtë klasifikim të përkthyesve, si edhe të strategjisë që përdoret për të përkthyer, është e thjeshtë ta kuptojmë edhe klasifikimin që i njëjti autor ua bënë teksteve të përkthyer: të ngjeshur dhe të zgjeruar. Për Lefevere përbën shqetësim dilema që kanë përkthyesit për zgjedhjen e strategjisë së përkthimit, të cilëve u duhet, në njërin anë, ta përballojnë tryshninë e studiuesve skrupulozë të gjuhës për një përkthim sa më besnik, që do të thotë konservator, ndërkohë që duhet ta kënaqin edhe ambicien e tyre për ta sjellë librin e përkthyer në një variant sa më të kënaqshëm për lexuesin e veprës në gjuhën “e re”. Lefevere citon A. S. Way, që përdor termat *traduttore* dhe *traduttore*. *Traduttore* është përkthyesi konservator, ndërsa *traduttore* është përkthyesi shpirtëror:

Traduttore, që me vullnet të plotë nuk dëshiron të jetë *traditore*, mund të mos heqë pjesë nga teksti ose të ndryshojë, dhe të themi se po përkthen me sa është e mundur, në mënyrë të atillë që studiuesi (i pakorruptueshëm) ka kënaqësinë skrupuloze e të mos gjeturit të asnjë fjale që i është bërë bisht, ndërsa lexuesi që nuk di greqisht mund të

kalojë, pa më të voglin dyshim, nga një pjesë në një tjetër aspak tërheqëse - ndërkohë që edhe përpjekjet më të mëdha nuk e bëjnë autorin që ka përkthyer të vlefshëm për t’u lexuar (me zë të lartë) as edhe në një shkollë vajzash (Ibid, f. 34).

Dallimin ndërmjet përkthyesit konservator dhe shpirtëror, ose *tradutores* dhe *traditores*, përkthyesi shqiptar prof. Edmond Tupja e shpreh në mënyrë elegante, duke përdorur termat *përkthyes* dhe *përthyes*. Por, pavarësisht prej strategjisë së zgjedhur të përkthimit, për Lefevere përkthimi është rishkrimi i veprës në gjuhën e përkthyer, ndërsa vetë përkthyesi, bashkautori në gjuhën e re, atë të përkthyer.

Në synimin për ta rivlerësuar rolin e përkthyesit, një nga nismat më të fundit vjen nga Britania. Juria e “Man Booker Prize” ka vendosur që çmimi për autorin më të mirë të huaj të botuar në anglisht të ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet autorit dhe përkthyesit.

Edhe Umberto Eco është shumë mirënjohës për punën e përkthyesit të tij, kur shprehet për *The Telegraph*: “Emri i trëndafilut” nga Bill Weaver (përkthyesi i veprës nga anglishtja në italisht) është më i mirë sesa “Emri i trëndafilut” nga Umberto Eco. Sa iu takon botimeve shkencore, ku ekziston mendimi i përgjithshëm që shkalla e “konservatorizmit” të përkthyesit duhet të jetë sa më e lartë, në të gjitha stilet kryesore të referimit të një vepre të përkthyer, kërkohet që, krahas emrit të autorit, të referohet edhe emri i përkthyesit. Për shembull, stili Çikago mund të ilustron në këtë mënyrë:

1. Në rastin e bibliografisë: Lahiri, Jhumpa. *In Other Words*. Translated by Ann Goldstein. New York, *Alfred A. Knopf*, 2016.²

Sharma, Ruchir. *Ngritja dhe rënia e kombeve*. Përkthyer nga Valbona Nathanaili. Prishtinë, *Pema*, 2017.

2. Në rastin e shënimeve, që zakonisht vendosen në fund të librit:

1. Jhumpa Lahiri, *In Other Words*, trans. Ann Goldstein (New York, *Alfred A. Knopf*, 2016), 146.

2. Ruchir Sharma. *Ngritja dhe rënia e kombeve*. Përkth. nga Valbona Nathanaili (Prishtinë, *Pema*, 2017), 146.

Në botimet shqip, pas viteve 1990, roli i përkthyesit ka prirjen të

minimalizohet. Në kontratat që shtëpitë botuese lidhin me përkthyesin, përveç detajeve teknike që kanë lidhje me mënyrën e pagesës, detyrimit të përkthyesit për ta mbajtur veprën e fshehtë dhe të drejtës së botuesit për t’u identifikuar si “pronar i përkthimit”, mungojnë elementet që promovojnë përkthyesin si bashkautor të veprës.³ Duket se me dorëzimin e veprës lidhjet e mëtejshme ndërmjet krijuesit dhe produktit reduktohen në zero.

Ende, përsëri për botimet shqip, ekziston dukuria e mosreferimit të përkthyesit të parë nga përkthyesit e mëvonshëm. Pra, është krijuar modeli, arketipi, mostra, por është lënë mënjanë. Këtë fat e kanë kryesisht ata përkthyes që kanë përkthyer vepra që nuk janë të mbrojtura nga e drejta e autorit. Dukuria është më e mprehtë në rastet kur veprat nuk paraqesin vëllim të madh pune.

II. Referimi dhe mosreferimi i emrit të përkthyesit të parë

Rasti “Jusuf Vroni”

Në vitin 1963 Jusuf Vroni fillon punë si përkthyes pranë Shtëpisë Botuese “8 Nëntori”, Tiranë. Sapo ka lënë pas shpine 15 vjet burg dhe internime. Fillon të përkthejë, për herë të parë, vepra të Ismail Kadaresë, nga shqipja në frëngjisht. Vepra e zgjedhur për përkthim është “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”.

Romani botohet në frëngjisht me titull “General de l’armée morte”. Fillimisht në Shqipëri në vitin 1968 nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” dhe, në vitin 1970, në Francë, por në të dyja botimet frëngjisht mungon emri i përkthyesit. Si ish i dënuar për agitacion dhe propagandë, emri i tij nuk është i denjë për t’u identifikuar. Por vepra ka sukses.

Shtëpia Botuese “8 Nëntori” vendos të botojë një vepër të dytë të Ismail Kadaresë. Përkthyesi është përsëri Jusuf Vroni. Vepra e Kadaresë botohet në frëngjisht në vitin 1978, përsëri në Francë. Këtë radhë është edhe emri i përkthyesit, Jusuf Vroni.

Përshtypja e përgjithshme është që veprat e Kadaresë janë po aq të mira edhe në frëngjisht falë përkthimit të Vronit. Përkthimet në anglisht të shumë prej veprave të Kadaresë janë bërë nga përkthyesi David Bellos, mbi bazën e frëngjishtes së Vronit. Në të gjitha rastet, përkthyesi i referohet Jusuf Vronit. Më poshtë janë sjellë dy tituj, *Piramida* dhe *Kështjella*:

Botimi shqip: 1992, *Piramida*. Ismail Kadare. Tiranë, *Çabej MÇM*, 139 f. (ribotuar: *Onufri*,

2010, 183 f.).

Botimi frëngjisht: 1994, *La Pyramide* (Le Livre de Poche). Paris, Fayard, 158 f.

Botimi anglisht: 1996, *Pyramid*. Ismail Kadare. Përktheu në anglisht: David Bellos (transl. from the French of J. Vronit). New York, *Arcade*, 161 f.

Botimi shqip: 1970, *Kështjella*. Ismail Kadare. Tiranë, *Naim Frashëri*, 237 f.

Botimi frëngjisht: 1972, *Les tambours de la pluie*. Ismail Kadare. Paris, *Hachette*, 342 f.

Botimi anglisht: 2008, *The siege*. Ismail Kadare. Përktheu në anglisht: David Bellos (This translation made from the French translation by Jusuf Vroni of the Albanian original). New York, *Canongate*, f. 328.

Rasti “Charles Kenneth Scott Moncrieff”

Botimi i parë, në anglisht, i veprës së Marcel Proust (1871-1922) “À la recherche du temps perdu” u bë nga Dover Thrift Editions, në vitin 1922, dhe doli në qarkullim, njëkohësisht, edhe në ShBA dhe Angli. Përkthyes ishte Charles Kenneth Scott Moncrieff, bashkëkohës i Marcel Proust.

Për botimin anglisht, Moncrieff zgjodhi si titull “Remembrance of Things Past (Kujtim i gjërave të së shkuarës), sipas titullit të një prej soneteve të Shekspir. Në fakt, vetë Prousti ishte kundër këtij ndryshimi, pasi nuk ishin të pranishme fjalët “kohë” dhe “kërkim” që janë në titullin frëngjisht.

Historia interesante që shoqëron përkthimin anglisht nga Moncrieff gjendet në parathënien e botimit të vitit 2006, të Wordsworth Editions, shkruar nga Ingrid Wassennar (f. 16-17).

Përkthimi është gjithmonë një art i trazuar dhe ta përkthesh Proustin është si të ecësh në një fushë të minuar. Para së gjithash, zgjatja në kohë e novelës, për afër 14 vjet. Tjetër: gjatësia e fjalive. Së treti, shkalla e lartë e kulturës së referuar. E katërta, fakti që novela nuk u përfundua kurrë. Të gjitha këto shpjegojnë përse Charles Kenneth Scott Moncrieff (1889-1930) nuk ishte thjesht përkthyesi i parë i Proust në anglisht, por mbeti i tillë deri në vitet ‘80. Ende Moncrieff pati disa përparësi sa i takon të tjerëve, ndoshta sepse jetoi dhe punoi në kohën që Prousti shkruante veprën e tij “Swann’s Way” (vëllimi i parë) është publikuar rreth vitit 1922. Moncrieff ishte i magjepsur mbas vizionit, stilit dhe përfshirjes që kishte vepra; e njëjta punë, e njëjta përpjekje për ta formatuar anglishten me frëngjishten e Proust, për ta dhënë edhe për

lexuesin anglishtfolës të njëjtën elegancë e përdorim individual të gjuhës, ndonëse është “akuzuar” vazhdimisht se është “tepër korrekt”.

Me këtë titull dhe me të njëjtin përkthim, novela njohu botime dhe ribotime të shumta deri në vitin 1981.

Në botimin anglisht të vitit 1981, për herë të parë mbas 59 vjetësh, emrit të Moncrieff si përkthyes i shtohet edhe Terenc Kilmartin. Arsyeja: botimi frëngjisht i vitit 1954 nga *Pléiade* kishte ndryshime të shumta. Shtëpia botuese franceze kishte skanuar çdo shënim, dorëshkrim a shenjë që gjendej në kopjen origjinale dhe të gjitha ishin pasqyruar në botimin e ri. Kilmartin, përkthyesi “i ri” i veprës, përpos pasqyrimit të ndryshimeve në tekstin e *Pléiade*, ndryshoi edhe titullin: “Në kërkim të kohës së humbur”. Tashmë, përkthyes janë dy, përkthyesi i parë i veprës, si dhe përkthyesi i dytë: Charles Kenneth Scott Moncrieff & Terenc Kilmartin.

Një rishikim tjetër i tekstit në gjuhën origjinale, në vitet 1987-1989, nga i njëjti botues, *Plejad*, çoi në nevojën për rishikimin e përkthimit të Moncrieff Camp; Kilmartin. Shtëpia botuese zgjedh përkthyesin D. J. Enright. Tashmë janë tre përkthyes: Charles Kenneth Scott Moncrieff & Terenc Kilmartin & D. J. Enright.

Në fakt, anglishtja ka ndryshuar më shumë se frëngjishtja: gjuha frënge është mbrojtur fuqishëm nga ndryshimet, ndërkohë që anglishtja i është nënshtuar përzierjes me neologjizma të ndryshëm. Por, me gjithë ndryshimet e herëpashershme që ka pësuar anglishtja, ose që në përkthimin anglisht mund të gesh “shtesa” që nuk gjenden në original, deri në ditët e sotme të gjithë i referohen përkthimit të Moncrieffit.

Mbas vitit 1987, duke qenë se vepra binte në “hapësirë publike”, të gjitha shtëpitë botuese që morën iniciativën për ta botuar veprën, krahas përkthyesve ose redaktorëve të tyre, ruajtën ose citojnë gjithmonë përkthimin e Moncrieffit. “Random House” i referohet përkthimit në këtë formë: Përkthyer nga Moncrieff & Kilmartin. Rishikuar nga D. J. Enright. Për më tepër, edhe të gjitha botimet rreth veprës së Proust u referohen përkthimit të Moncrieffit. Botimi i Cambridge “The Cambridge Introduction to Marcel Proust”, autor Adam Watt, Cambridge University Press, 2011, f. ix, shkruan: “Të gjitha citimet u referohen botimit të Vintage Classics në gjashtë volume përkthyer nga C. K. Scott Moncrieff (me përjashtim të “Time Regained”, përkthyer nga Andreas Mayor dhe Terence Kilmartin), rishikuar nga Terence Kilmartin dhe D. J. Enright (Vintage, 2000-2)”. Edhe “Penguin Books” që më

2003 porositi një përkthim të ri dhe mori nga një përkthyes të ndryshëm për secilin prej shtatë volumeve, përsëri i referohet Moncrieffit.

Rasti “Petro Zheji” dhe përkthimi i Henrik Ibsenit

Me një parantezë të shkurtër, Henrik Ibsen (1828-1906) ka vdekur më 23 maj 1906 dhe vepra e tij është në “hapësirën publike” pothuaj në të gjithë botën, pasi kanë kaluar më shumë se 100 vjet nga viti që autori ka ndërruar jetë. Në vendin tonë ka hyrë në hapësirën publike në dhjetor të vitit 1976 (ose janar 1977).

Deri në vitet 2000, të gjitha përkthimet dhe ripërkthimet e dramës së njohur mbajnë firmën e përkthyesit Gjergj Zheji.

Botimi i parë i takon vitit 1965. Drama e Ibsenit u botua në shqip me titullin “Shtëpia e kukullës” (së bashku me “Rosa e egër”), nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”.

Në botimin e dytë të vitit 1976, afër dhjetë vjet më vonë, me të njëjtën dhe të vetmen shtëpi botuese që operonte në atë kohë, Gjergj Zheji duhet t’i jetë rikthyer edhe një herë punës me veprën, sepse ka ndërruar titullin. Në këtë botim të ri, vepra vjen nën titullin “Shtëpi kukulle” (në botim gjendet përsëri edhe drama tjetër “Rosa e egër”, por titulli i saj është i njëjtë).

Ekziston edhe një botim i tretë po nga i njëjti përkthyes, i vitit 2006, por nga Shtëpia Botuese “Argeta-LMG”. Titulli është ai i botimit të dytë: “Shtëpi kukulle”.

Duke kërkuar në libraritë e Tiranës për botime të tjera, gjeta edhe një botim tjetër, të së njëjtës vepër nga Shtëpia Botuese “Kuçuku”, viti 2013. Përkthyesi, Artan Duka, kishte zgjedhur titullin “Një shtëpi kukulle”.

Nëse e krahasojmë këtë shembull me shembullin e përkthimit të veprës së Proustit në anglisht, asnjëri nga krijuesit tanë nuk ka pasur fatin të bashkëpunojë me autorin dhe kjo, ndoshta, mund të jetë arsyeja se pse, që në titull, të dy përkthyesit kanë pasur variacione të dukshme. Jo pa qëllim zgjodha këtë vepër, pasi jo vetëm i njëjti përkthyes e ka ndryshuar konceptimin e titullit, por edhe një i dytë ka zgjedhur një variant të ri, pra tre përkthime të ndryshme për një titull: “Shtëpia e kukullës”, Zheji, 1965; “Shtëpi kukulle”, Zheji, 1976; “Shtëpi kukulle”, Zheji, 2006 dhe “Një shtëpi kukulle”, Duka, 2013.

Zheji e ka rilexuar veprën pas dhjetë vjetësh dhe ka konkluduar me një titull të ri. Shtëpia botuese që ka botuar përkthimin e së njëjtës vepër nga një përkthyes i ri, Duka, nuk e referon përkthimin e Zhejit. Përkthyesi i mëvonshëm, afër 48 vjet pas botimit të parë të përkthimit të parë të së njëjtës vepër, ka zgjedhur një titull të ri: kohë të ndryshme japin perceptime të ndryshme - kështu ndodh me leximin e çdo vepre. Por është e arsyeshme që kur kemi sisteme

të mëparshme, t’u referohemi, thjesht sepse është më e thjeshtë të ndërtosh koordinatat e, bashkë me to, edhe të gjithë lëvizjen përpara.

Rasti i *Zemrës së Edmondo De Amicis*

Zemra e Edmondo de Amicis është përkthyer nga tetë përkthyes të ndryshëm, në një interval kohor prej 93 vjetësh. Janë tetë përkthyes, nga të cilët një është në Kosovë. Përkthyesin e Kosovës i jam referuar veçan për shkak të situatës që ka qenë përpara viteve 1990 dhe për këtë arsye nuk është bërë pjesë e analizës. Për *Zemrën* e Edmondo de Amicis, në Shqipëri, afërsisht çdo trembëdhjetë vjet kemi një përkthyes të ri. Por, po ta ndajmë me periudha, situata paraqitet shumë më ndryshe. Përgjatë periudhës 1923-1999, ose për 74 vjet janë vetëm dy përkthyes të ndryshëm, ndërsa gjatë periudhës 1997-2016, ose për 19 vjet, kemi pesë përkthyes të ndryshëm.

1. 1923 (1932), *Zemra*. Autor Edmondo De Amicis. Karl Gurakuqi (përkth. nga ital.) Tiranë, Ministria e Arsimit, 1923. Të dhëna fizike III + 254 f.; 19 cm. Shënime: Shtypshkronja “Mbrothësia” e Kristo Luarasit; ka parathënie nga Terenc Toçi, f. I-III. Botimi i dytë, 1932. Tiranë, Shtypshkronja “Nikaj”. Të dhëna fizike IV + 315 f.; 20 cm. Shënime: ka parathënie nga Mati Logoreci f. I-IV.

2. 1957, *Zemra*. Autor Edmondo De Amicis. Halit Selfo (përkth.) Tiranë, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1957. Të dhëna fizike 252 f.; me ilustrime.

3. 1997, *Zemra*. Autor Edmondo De Amicis. Vali Xhixha (përkth.). Tiranë, Mësonjëtorja e parë, 1997. Të dhëna fizike 266 f.; 20 cm.

4. 2004, *Zemër*. Autor Edmondo De Amicis. Agim Doksani (përkth.) Xhevahir Lleshi (red.). Tiranë, *Uegen*, 2004. Të dhëna fizike 243 f.; me ilustrime; 20 cm.

5. 2005, *Zemra*. Autor Edmondo De Amicis. Klara Kodra (përkth.) Flora Koka (red.). Tiranë, *Extra*, 2005. Të dhëna fizike 306 f.; 21cm.

6. 2011, *Zemra*: ditari i një nxënësi italian Autor Edmondo De Amicis. Jonis Buzi (përkth. nga angl.) Fatos Hoxha (red.). Tiranë, *Alba Prim*, 2011. Të dhëna fizike 299 f.; 20 cm.

7. 2016, *Zemër*. Autor Edmondo De Amicis. Rigel Rizaj (përkth. nga origj.) Dorina Basha (red.). Tiranë & Tetovë & Prishtinë, *Albas*, 2016. Të dhëna fizike 304 f.; 20 cm.

Në Kosovë

1961 (1973), *Zemra*. Autor Edmondo De Amicis. Anton Çetta (përkth. prej. italisht.) Prishtinë, *Rilindja*, 1961. Të dhëna fizike 255 f.; me ilustrime; 20 cm. Botim i dytë: 1973. Prishtinë, *Rilindja*, 279 f.

Rasti i “Të mjerëve” të Viktor Hygos

Ky roman njeh vetëm dy përkthime në gjuhën shqipe: përpara vitit 1944 nga Kristo A. Dako dhe pas vitit 1944, ku në të gjitha botimet dhe ribotimet është vetëm emri i përkthyesit Misto Treska. Vepra ka, në total, me afërsi, 1 700 faqe të shtypura në format B5 në variantin e Treskës, ndërsa Dako jo vetëm nuk duhet ta ketë mbaruar përkthimin, por edhe ka punuar me ndonjë variant të shkurtuar, të paktën nga të dhënat që ka Biblioteka Kombëtare. (Shihni, ju lutem, numrin e faqeve).

1935, *Të mjerët*. Roman historik. Autor Victor Hugo. Kristo A. Dako (përkth.) Tiranë, *Kristo Luarasi*, 1935. Të dhëna fizike V. 1, 109 f.: me il.

1938, *Të mjerët*. Autor Victor Hugo. Kristo A. Dako (përkth.) Tiranë: Kristo Luarasi, 1938. Të dhëna fizike V. 1, Pj. 2, 184 f.: me il.

1982, *Të mjerët*. Autor Victor Hugo. Misto Treska (përkth.) Dorina Paço (red.) Tiranë, *Naim Frashëri*, 1982. Të dhëna fizike V. 3, 640 f.

1983, *Të mjerët*. Autor Victor Hugo. Misto Treska (përkth.). Dorina Paço (red.). Tiranë, *Naim Frashëri*, 1983. Të dhëna fizike V. 1, 579 f.

1983, *Të mjerët*. Autor Victor Hugo. Misto Treska (përkth.) Dorina Paço (red.). Tiranë, *Naim Frashëri*, 1983. Të dhëna fizike V. 2, 684 f.

2012, *Të mjerët*. Autor Victor Hugo. Misto Treska (përkth. nga origj.) Kujtim Gjonaj (red.). Tiranë, *Bota Shqiptare*, 2012. Të dhëna fizike V. 1, 526 f.; 20 cm.

2012, *Të mjerët*. Autor Victor Hugo. Misto Treska (përkth. nga origj.) Kujtim Gjonaj (red.) Tiranë, *Bota Shqiptare*, 2012. Të dhëna fizike V. 2., 605 f.; 20 cm.

2012, *Të mjerët*. Autor Victor Hugo. Misto Treska (përkth. nga origj.) Kujtim Gjonaj (red.). Tiranë, *Bota Shqiptare*, 2012. Të dhëna fizike V. 3, 572 f.; 21 cm.

Konkluzione

Në përkthimet shqip të sjella si shembuj, në të gjitha rastet nuk i referohet përkthyesit të mëparshëm sa herë ka qenë i ndryshëm. Ka vepra që janë përkthyer disa herë, nga përkthyes dhe shtëpi të ndryshme botimi, por ato asnjëherë nuk i referohen përkthyesit të mëparshëm. Me argumentin se përkthyesi është bashkautor i veprës në gjuhën e përkthyer, secili nga përkthyesit sjell përvojën dhe strategjinë e tij në përkthimin e ri që i bën të njëjtës vepër. Norma e shkruar, në trajtën e ligjit, nuk e ndalon përkthimin e ri në asnjë nga rastet. Normë e pashkruar, që duket se në rastin tonë mungon, është konsultimi me një përkthim të mëparshëm. Dhe referimi.

Propozime

1. Ndryshe nga Lefevere që për përkthyesin përdor termin

“bashkautor”, mendoj se mund ta përdorim termin “*kuazi*-autor”. Fjala “bashkautor” do të thotë se autori dhe përkthyesi kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin por, përgjithësisht, nuk është e vërtetë. Ndërsa fjala *kuazi*, që do të thotë *pothuaj* (të ngjashëm në një farë mase, por ndryshojmë nga...) është huazuar nga fizika dhe përdoret për ta referuar sasinë e energjisë që emetohet nga një thërmijë e ngacmuar falë ndërveprimit me mjedisin përreth. Energjia e emetuar, pasi është shkëputur nga trupi që e ka lëshuar, vazhdon të përhapet në mjedis por, ndonëse është valë, ka karakteristikat e një thërmije. Për këtë arsye quhet *kuazi*-thërmijë.

Në mënyrë të ngjashme, përkthyesi është ai që e merr veprën e autorit dhe e çon në një gjendje të re, nga një gjuhë në një tjetër, nga një kulturë në një tjetër, falë një sërë ndërveprimesh që karakterizojnë këtë ndryshim. Vepra e përkthyer është *kuazi*-vepër dhe vetë përkthyesi është *kuazi*-autor.

2. E drejta për t’u cituar emrat e përkthyesve të mëparshëm, si kur është një, edhe kur janë më shumë. Për veprat që kërkojnë marrjen e të drejtës së autorit - dhe zakonisht është vetëm një shtëpi botuese që e ka këtë të drejtë - problemi është më i thjeshtë. Vështirësia qëndron në veprat që bien në hapësirën publike. Këtu kërkohet vullnet i mirë.

3. E drejta për t’u paraqitur emri i përkthyesit në kopertinën e librit, me një madhësi fonti modeste e në një vend të pershtatshëm.

4. E drejta e përkthyesit për të shkruar një parathënie ose pasthënie për botimin shqip. Parathënies së botimit në gjuhën origjinale - nëse ka - mund t’i shtohet edhe një parathënie e vet përkthyesit, ku pjesë e saj të jetë strategjia e përkthimit, përshtatja që u ka bërë në gjuhën shqipe termave të ndryshëm - si një kontribut ndaj lexuesit shqiptar - zgjedhjen që ka bërë sa i takon gjuhës që ka përdorur (gjuhën zyrtare apo dialekt), pse është bërë kjo zgjedhje etj.

(*Marrë nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, “Akademia”*)

Literatura:

B czkowska, Anna (Ed.) (2015), *Perspectives on Translation*. Cambridge Scholars Publishing Chicago Style. Gjetur: http://www.chicagomanualofstyle.org/tools_citationguide.html (dt. 19.3.2018)

Lefevere, Andre (1992), *Translation, Rewriting and the Manipulation of Literary Fame*. Routledge

Nathanaili, Valbona (2014), *Paralele përthyerjesh. Milosao, Gazeta shqiptare*, 9 shkurt 2014

E jashtëzakonshme

Gruaja "bllokon" trafikun për të marrë rreze dielli në asfalt

Lily Willetts ishte së bashku me partnerin e saj Sam Wadsworth në rrugë për në Blackpool kur ngecën në trafik për shkak se një makinë kishte bërë aksident. Por, Lily ka përfituar nga rasti t'i shijonte rrezet e diellit duke u shtrirë në asfalt.



FOTO E DITES



Avulli shihet duke dalë nga qarja e asfaltit në Havai. /USGS/

E rrallë

Kamioni me çokollatë rrokulliset në autostradë

Një kamionin është rrotulluar në një autostradë në shtetin polak, duke derdhur tonelata çokollatë. Transmetuesi privat "TVN24" ka përcjellë imazhet e kamionit të përmbysur të rrethuar nga çokollata ngjyrë kafe që mbulonte gjashtë korsi në autostradën A2, duke bllokuar trafikun në të dyja drejtimet.



BARSOLETA E DITËS



Plaka: O bir, ku gjendet varreza numër 190?

Rojtari: Po pse del nga varri kur nuk di të kthehesh?!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING"

(PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW"

(R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenerts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Sot jeni shumë të ndikuar nga ana emocionale. Mbase ka të bëjë me lëvizjen e planetëve në shenjën tuaj.



DEMI

Keni ndërsjellje të mendimit dhe ndjenjave sot. Nuk dini se çfarë të bëni në këtë udhëkryq të çuditshëm.



BINJAKËT

Çdo impenjim të ditës do ta zhvilloni në qetësi të plotë. Sot gjithçka do të rrjedhë qetë dhe pa ndonjë emocion të çuditshëm.



GAFORRJA

Sot nuk do të kënaqeni me atë çka ju ofron partneri. Do të kërkonti më shumë dhe kjo do të ndezë një debat të fjetur.



LUANI

Krenaria juaj e sëmurë do të ketë pasoja në marrëdhënien në çift. Problemet do të thellohen çdo ditë e më shumë.



VIRGJËRËSHA

Sot keni në mendje një projekt të rëndësishëm që doni ta bëni realitet sa më shpejt. Do ta kërkonti ndihmën e miqve.



PESHORJA

Dita do të përshkruhet nga kreativiteti dhe do të merreni me ato aktivitete aq të këndshme kulturore që i kishit lënë pas dore.



AKREPI

Blerjet kohët e fundit kanë qenë vërtet të goditura. Asnjë gjë që keni marrë nuk do të shkojë dëm.



SHIGJETARI

Kjo ditë nuk ngjan fare me ditët e rrëmuishme që keni gjatë javës. Do të shijoni çdo moment të saj sepse ju mungonte qetësia.



BRICJAPI

Dita sot do të jetë mjaft produktive dhe do të mbyllet nga një mbrëmje e këndshme në shoqëri të mirë.



UJORI


Keni probleme në përditshmërinë tuaj dhe kjo gjë po ju shqetëson. Edhe pse jeni një shpirt i lirë, sot dëshironi t'ju robërojnë dikush.



PESHQIT

Energjia pozitive dhe miqtë bëjnë që kjo ditë të ecë shumë mirë dhe ju do të jeni gjithë kohën në buzëqeshje.

Perry - Swift, më në fund bëjnë paqe



Një degë të vërtetë ulliri i ka dërguar Katy Perry rivalet së vjetër Taylor Swift, me qëllimin e qartë që t'i japë fund përballjes mes dy superyjeve. Swift, që do të nisë së shpejti një turne të sajën, ndau një video të pakos që kishte marrë nga Perry


ku, përveç degës së ullirit, kishte edhe një shënim me fjalët "Më vjen keq". Dega e ullirit është simbol i paqes. Të dy këngëtaresh ishin përfshirë në një zënkë në lidhje me kërcimtarët shoqëruar, e kishin shkruar edhe këngë për njëra-tjetrën.

Rita Ora më 3 qershor në Tiranë



Përmes një postimi në llogarinë e vet në rrjetin social "Facebook", Rita Ora ka shkruar se ndihet e ngazëllyer që do të shkojë në Tiranë më 3 qershor. "E ngazëllyer për të shkruar në Tiranë,

kryeqytetin e Shqipërisë, gjithnjë në ndryshim, për një shfaqje të shkëlqyer më 3 qershor në Sheshin e mahnitshëm 'Skënderbej'. Mezi pres për të festuar me të gjithë ju. Tirana Rocks", ka shkruar Rita Ora.




Kim Kardashiani mahniti me veshjen në Met Gala

Embuluar me ar dhe mjaft sensuale si gjithmonë, Kim Kardashiani ka mahnitur në Met Gala. Kim i ishte përshtatur tematikës së këtij viti në Met Gala, duke vendosur një kryq në qafë dhe, po

ashtu, në fustan kishte vendosur simbolin e kryqit. Ylli i "Keeping Up With Kardashians" u shfaq në tapetin e kuq me një fustan të markës "Versace" dhe sytë e të gjithëve ishin tek ajo.

Bieberi: Jeta në 'Instagram' nuk është e vërtetë

Ylli i popit, Justin Bieber, është një ndër personazhet më të pëlqyer të publikut dhe ndër më të ndjekurit në rrjetet sociale. Ai ka bërë një postim në "Instagram" që i ka çuditur të gjithë. "Hej njerëz, ajo jeta luksoze dhe shumë e bukur që shihni të paraqitet nga personazhet e famshëm në 'Instagram' nuk është e vërtetë. Mos u gënjeni duke menduar se ata kanë jetë më të mirë sesa e kenë ju. Ju premtoj se nuk është!", ka shkruar Bieber.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT Pilkington
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

RUDES - NK SLAVEN

1

TRIGLAV - NK CELJE

GG

BASLE - YOUNG BOYS

1

Karateistët e Kosovës s'lejohen të hyjnë në Serbi

Karateistët e Kosovës dy herë gjatë ditës së mërkurë nuk janë lejuar të hyjnë në Serbi për të marrë pjesë në Kampionatin Evropian i cili mbahet në Novi Sad. "Nëpërmjet Komitetit Olimpik na njoftuan se e kemi edhe një shans për të shkuar në Serbi, por derisa erdhëm këtu kryetari i Federatës Evropiane të Karatesë, Antonio Spinoza, më ka telefonuar dhe ka shprehur keqardhje se Ministria e Serbisë nuk lejon ardhjen e Kosovës. Ai më njoftoi se pas përfundimit të këtij kampionati do të merren të gjitha masat lidhur me këtë rast", ka thënë Ismet Krasniqi



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 MAJ - Ekspedita e Kombëtares së Kosovës në Karate të mërkurë nuk është lejuar dy herë të hyjë në shtetin e Serbisë. Policia serbe, me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, nuk ka lejuar karateistët e Kosovës të hyjnë në Serbi për të marrë pjesën në Kampionatin Evropian, i cili do të mbahet nga 10 deri më 13 maj në Novi Sad.

Kryetari i Federatës së Karatesë së Kosovës (FKK), Ismet Krasniqi, ka thënë se këtë veprim nga shteti serb nuk e kishin pritur për faktin se Federata Evropiane dhe ajo Botërore e Karatesë kishin premtuar se nuk do të ketë pengesa. "Policia serbe na kumtoi vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, se ka urdhër për të mos na lejuar të hyjmë në Serbi. Këtë nuk e kemi pritur, pasi kemi pasur biseda me drejtuesit e Federatës Evropiane të Karatesë dhe ata të Federatës Botërore të Karatesë, se nuk do të kemi pengesa për të garuar dhe se do të garojmë të barabartë, sepse Serbia është vetëm organizatore teknike. Ky ka qenë qëllimi i Serbisë për të na ndaluar në kufi", ka thënë Krasniqi.

Pas kthimit në Prishtinë, Federata e Karatesë mbajti një konferencë për medie, duke bërë me dije se Federata Serbe dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë kanë kërkuar që për 48 orë t'i kenë emrat e të gjithë personave që do të shkojnë në Novi Sad, derisa këtë procedurë FKK-ja e kishin kryer tri ditë më herët. "Arsyeja e ndaljes ka qenë banale. Kanë kërkuar t'i dër-

gojmë të gjitha emrat. Kërkesa ka qenë për 48 orë më herët, kurse ne i kemi dërguar tri ditë më herët. Polici i kishte letrat tona në dorë, të cilat i dërguam më 3 maj. Ata na thanë na vjen keq, por urdhri është të ktheheni mbrapa", ka deklaruar Krasniqi.

FKK-ja ka tentuar, në koordinim me Federatën Evropiane të Karatesë, të hyjë në Serbi edhe në orët e pasdites, por prapë ka ndodhur e njëjta gjë dhe ekspedita e Kosovës është ndaluar në Merdare. Pas dështimit për herë të dytë, kryetari i FKK-së, Ismet Krasniqi, ka bërë me dije se kryetari i Federatës Evropiane e ka telefonuar nga Serbia dhe i ka konfirmuar se pala serbe është e vendosur të mos lejojë pjesëmarrjen e Kosovës në këtë kampionat. "Nëpërmjet Komitetit Olimpik na njoftuan se e kemi edhe një shans për të shkuar në Serbi, por derisa erdhëm këtu kryetari i Federatës Evropiane të Karatesë, Antonio Spinoza, më ka telefonuar dhe ka shprehur keqardhje se Ministria e Serbisë nuk lejon ardhjen e Kosovës. Ai më njoftoi se pas përfundimit të këtij kampionati do të merren të gjitha masat për këtë rast", ka thënë Krasniqi.

Pas pengesës që iu bë ekspeditës së karatesë, ka reaguar edhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK). "Vendimi i Qeverisë së Serbisë për përzierjen në sport është në kundërshtim me Kartën Olimpikë, me statutin e Federatës Botërore të Karatesë dhe me të drejtat e njeriut. Një vendim i tillë i lig, i cili ndodhi në kufirin e Merdares, nuk përkon me frymën sportive. Karateistët tanë nuk janë nisur për në Novi Sad si turistë, por me ftesë të Federatës Evropiane të Karatesë,

si organizatore e Kampionatit të 53-të Evropian për Seniorë. Sot u bënë përpjekje për shuarjen e ëndrrave të shumë karateistëve për rezultate në nivelin evropian, duke iu mohuar shanset për të fituar medalje në kampionatin evropian dhe pikë për kualifikim në Lojërat Evropiane Minsk 2019 dhe Lojërat Olimpikë Tokio 2020", thuhet në reagimin e KOK-ut.

Pas pamundësimit të pjesëmarrjes së karateistëve të Kombëtares së Kosovës në Kampionatin Evropian, ka reaguar edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi. "Shteti serb tregoi se nuk është reformuar dhe s'ka ndryshuar nga mendësinë e vjetër. Ai kundërshton normat e frymës sportive që institucionet sportive evropiane e botërore kanë instaluar. Me ndalimin e karateistëve kosovarë, duke pamundësuar të marrin pjesë në një garë të organizuar nga Federata Evropiane e Karatesë, ajo ka dëmtuar emocionalisht dhe ka shuar ëndrrën e karateistëve tanë që të barabartë të garojnë me karateistë të shteteve të tjera", ka thënë Gashi, duke shtuar se: "Si Ministri e Sportit u bëjmë thirrje autoriteteve sportive evropiane dhe botërore të karatesë dhe sporteve të tjera që marrin masa kundër Serbisë, ta ndalojë njëherë e përgjithmonë ndërhyrjen në sport kur ka të bëjë me sportistët kosovarë. Nëse Serbia nuk është e

gatshme dhe e aftë të organizojë gara e ngjarje sportive në të cilat marrin pjesë edhe sportistët dhe njerëzit e tjerë të sportit nga Kosova, atëherë e drejta e organizimit të këtyre ngjarjeve mos t'i jepet fare Serbisë. Përfundimisht, Serbia duhet të disiplinohet nga autoritetet sportive botërore e evropiane në raport me sportin e Kosovës. Sporti është dhe duhet të mbetet i ndarë nga politika".

Reagojnë edhe presidenti Thaçi dhe kryeministri Haradinaj

Ndalimin e pjesëmarrjes së karateistëve të Kosovës në Kampionatin Evropian të Karatesë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka quajtur të papranueshëm. "Ndalimi i pjesëmarrjes së karateistëve kosovarë në Kampionatin Evropian të Karatesë për Seniorë në Novi Sad nga autoritetet e Beogradit është i papranueshëm, është kundër frymës sportive dhe rregullave elementare të Federatës Ndërkombëtare të Karatesë. Me sjellje të tilla Serbia po tenton ta politizojë edhe sportin, i cili duhet t'i bashkojë popujt dhe jo të krijojë ndarje mes tyre", ka thënë Thaçi. Ndalimin e sportistëve të Kosovës për të marrë pjesë në Evropianin e Karatesë e ka dënuar edhe kryeministri i Kosovës, Ramus Haradinaj.

Numri një i Qeverisë ka thënë se ky është një akt i papranueshëm, i papresedan dhe i tmerrshëm, për shkakullin 21 të kontekstit të integriteteve evropiane dhe nuk i kontribuon normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. "Ndalimi i Kombëtares së Kosovës për të marrë pjesë në Kampionatin Evropian të Karatesë në Novi Sad, kryeqytetin e Vojvodinës, është akt i papranueshëm, i papresedan dhe i tmerrshëm, për shkakullin 21 të kontekstit të integriteteve evropiane dhe nuk i kontribuon normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Kthimi nga Merdara në shtëpi i karateistëve tanë, duke mos i lejuar të garojnë në një event sportiv, është shkelje flagrante e të gjitha konventave ndërkombëtare për lëvizje të lirë dhe diskriminim në baza entike. Autoritetet serbe janë njoftuar më tre maj për këtë udhëtim dhe pretendimi se ato nuk janë informuar më kohë është i paqëndrueshëm. Po ashtu, Zyra Ndërlidhëse e Kosovës i ka njoftuar autoritetet e Serbisë për udhëtimin e sportistëve tanë për në Novi Sad", ka thënë Haradinaj. "Këtë akt ndalese të shtetit serb, të dytin me radhë, brenda një kohe të shkurtë, e konsiderojmë të papresedan dhe veprim që sinjalizon se Serbia po qëndron në politikat nacionaliste të konfliktit dhe refuzimit, në vend të bashkëpunimit dhe frymës së vlerave të përbashkëta evropiane", ka shtuar Haradinaj.

Kuka, Majlindës: Urime ambasadorja më e fuqishme e shtetit tonë!

PEJË, 9 MAJ - Krenaria e sportit dhe shtetit të Kosovës, Majlinda Kelmendi, sot e feston ditëlindjen e 27. Trajneri Driton Kuka e ka uruar kampionen olimpike,

kurse e ka quajtur ambasadoren më të fuqishme të Kosovës. "Majlinda sot feston ditëlindjen. Kampione evropiane, botërore dhe

olimpike, e vetmja shqiptare që ka arritur krejt titujt e mundshëm në sport. Urime dhe shëndet të uroj dhe jam shumë krenar me ty. Ambasadorja më e fuqishme

e shtetit tonë të ri, por ende pa pasaportë diplomatike, por me respektin më të madh në zemrat e shqiptarëve kudo që janë", ka shkruar Kuka në profilin e vet në "Facebook".



Dështon miqësorja Shqipëri - Kosovë



TIRANË, 9 MAJ - Pavarësisht prej marrëveshjes në mes të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) dhe Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), për zhvillimin e një miqësore në tokë neutrale, duket se ndeshja e programuar këtë vit do të dështojë. Federata zvicerane duhej ta siguronte lejen për zhvillimin e kësaj ndeshje miqësore, por helvetikët nuk pranojnë, me pre-

tendimin e se cenon sigurinë. Presidenti i FFK-së, Fadil Vokrri, në një intervistë për "KosovaPress", ka thënë se miqësorja ndaj Shqipërisë është pranë anulimit. "Po, afër anulimit, sepse Federata e Futbollit Zviceran nuk e ka dhënë lejen. Tashmë duhet vetëm njoftimi zyrtar për anulimin e miqësores që ishte programuar në fund të këtij muaji. Edhe opsionet për

zhvendosjen e miqësores në një stadium tjetër po bien ditaditës", ka thënë Vokrri. Lajmi është konfirmuar për "Top Channel" edhe nga presidenti i FSHF-së, Armand Duka. "Po, është e vërtetë ajo që ka deklaruar presidenti Vokrri. Jemi duke kërkuar mundësi të tjera për të shfrytëzuar këtë periudhë sa më mirë për ekipin dhe trajnerin", ka thënë Duka.

Houstoni dhe Golden State, finalistët për titull në Perëndim

HOUSTON, 9 MAJ - Houstoni dhe Golden State janë dy skuadrat finaliste të Konferencës së Perëndimit pas fitoreve të arritura sot, duke triumfuar 4-1 me ndeshje, respektivisht ndaj Utah Jazzit dhe New Orleansit. Houstoni mundi 112-102 Utah në përballjen e pestë gjysmëfinale, një ndeshje e ekuilibruar në shumicën e kohës, ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Vetëm në minutat e fundit erdhi përmbyjsja e ekipit teksan, me Chris Paulin që realizoi 41 pikë e 10 asistime, mbështetur nga Tuckeri me 19 pikë e Hardeni me 18. Për Jazzin, Mitchellli realizoi 24 pikë e Burksi 22, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, raporton "Telesport". Në finale shkon ekipi kampion i Golden States, që mundi 113-104 New Orleansin, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Warriorsit, që patën epërsi gjatë gjithë



kohës. Trioja Curry-Durant-Thompson realizoi 75 pikë, duke bërë diferencën në fushë. Për

New Orleansin u dallua Davidi me 34 pikë e 19 rebaunde, por që mbetën për statistikë.

KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE

Boston - Philadelphia (3-1 me ndeshje)
Toronto - Cleveland (0-4 me ndeshje)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE

Houston - Utah Jazz 112-102 (3-1 me ndeshje)
Golden State - New Orleans 113-104 (3-1 me ndeshje)

SHKURT

Më 13 maj turniri për dëshmorin Demush Mavraj

Turneu tradicional në futboll të vogël për dëshmorin e kombit Demush Mavraj do të mbahet edhe sivjet. Organizatorët e turnirit për ish-ushtarin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) dhe njeriun që gjithë jetën ka shërbyer për arsimin e brezave të rinj dhe për zhvillimin e sportit do të mbahet më 13 maj në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Burim. Sistemi i lojës do të jetë 4+1, kurse turniri fillon nga ora dhjetë. Si zakonisht, edhe në këtë turne për fituesit do të ketë medalje dhe Kupë.

Shabani nënshkruan kontratë profesionale me Bayernin

Meritan Shabani ka nënshkruar kontratë profesionale me Bayern Munichun. Mesfushori me prejardhje nga Kosova ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2020 dhe është shprehur i lumtur me këtë kontratë. "Bayerni është klubi im dhe jam shumë i lumtur që kam këtë mundësi", ka thënë ai pas nënshkrimit të kontratës.

Lëndohet Alves, rrezikon pjesëmarrjen në Kupën e Botës

Dani Alves mund të mbetet jashtë Kupës së Botës "Rusi 2018". Mbrojtësi brazilian u lëndua në ndeshjen finale të Kupës së Francës, ku PSG-ja e fitoi kundër ekipit inferior Les Herbiers (2-0). Dhjetë minuta pa përfunduar ndeshja, Alves u lëndua pa pasur ndonjë kontakt me ndonjërin prej kundërshtarëve. Tash priten ekzaminimet mjekësore për të parë se sa do të mungojë ish-mbrojtësi i Barcelonës.

Barça, gati ta paguajë klauzolën e Grizmannit


Të gjitha rrugët e çojnë drejt Barcelonës sulmuesin e kombëtares franceze, Antoine Griezmann. Mediat spanjolle bëjnë me dije se klubi blaugrana ka vendosur ta paguajë klauzolën e largimit të Griezmannit nga Atletico Madridi, e cila e kap shifrën e 100 milionë eurove. 27-vjeçari refuzoi ta rinovonte kontratën me "Los Colchoneros" dhe tanimë gjasat janë që francezi të largohet nga skuadra e Diego Simeones për të formuar një treshe të frikshme sulmuese te Barça me Leo Messin dhe Luis Suarezin. Duke iu referuar asaj që shkruan "Cadena Ser", drejtuesit e Barcelonës ua kanë komunikuar drejtuesve të Alteticos planin e tyre për ta paguar klauzolën e largimit prej 100 milionë eurosh të Griezmannit nga Atletico Madridi.

Real, 80 milionë për Lewandowskin

Robert Lewandowski është objektivi kryesor i Real Madridit për afatin kalimtar të verës. "Don Balon" ka njoftuar se "Los Blancos" ka ofruar 80 milionë euro për shërbimet e sulmuesit të Bayern Munchenit. Lewandowski ka pranuar se nuk ka vendosur nëse do të mbetet në Bayern Munich për sezonin e ri. Real Madridi mund ta sjellë Lewandowskin nëse e shet Karim Benzeman ose Gareth Balen.

Ozili rrezikon seriozisht Botërorin "Rusi 2018"

Një lajm jo i mirë që vjen për tifozët dhe trajnerin e Kombëtares së Gjermanisë është se Mesut Ozil është lënduar dhe mund të jetë jashtë Botërorit "Rusi 2018". Besohet se Ozili është lënduar në shpinë, por trajneri Joachim Low duhet t'i presë ekzaminimet mjekësore për të parë se a mund të llogarisë në shërbimet e mesfushorit. "Më vjen inat për dëmtimin. Do të më duhet edhe pak kohë për t'u rikuperuar plotësisht, por besoj se do të jem gati për në Botëror, edhe pse nuk ka asnjë diagnozë të saktë rreth dëmtimit tim", ka deklaruar Mesut Ozil.



	Autor: GAZMEND MORINA					I PAMBARUAR, I PAPËR- FUNDUAR	ALEANCA	FUTBOLLISTI ANGLEZ LENON	POSEDOJ DIÇKA	PARAPAGUES	UDHËHEQËSI I NJË ORGANIZATE	PËREMËR PRONOR	PJESËTAR I NJË POPULLI NË SRI LANKË	ZANORE	RASIM KIÇINA	EPOKA ERE
	QË NUK ËSHTË I KALITUR															KËNGËTARI ERION
	BIMË PARAARDHËSE												KUVENDI KOMUNAL IRMA LIBOHOVA			
	PËRSHTATJA													ZANORE I ZURE ME DORË		
	KNOËLEDGE TRANSFER NETËORK								NORVEGJIA, ESTONIA DRITËSHKU- RTËR		AKTORI REXHEPI KULAÇE (shq.)					
	RENS ISTVUD							AKTORJA E FAMSHME STRIP ZVOGËLIM I TEPËRT (sh.shq.)					KUDRET ISAI PJESA E SIPËRME QË MBYLL A MBULON NJË ENË			
	ZANORE						VËNIE E MINAVE BASHKËT.					ISH PORTIER OLIVER ... KËSTI BANKAR				
KONGRESM- ENI ENGEL										LETRARI FATOS MODELJA KANADEZE XHESIKA (shq.)					FATOS	
EPOKA ERE	PAVLEFSH- MËRI (jur.)	▼	AFTËSIA E PAGIMIT (treg.) DUKURI E RE	TONELATË	BASKETBO- LLISTI AMERIKAN SHEKIL	BASHKËT. NAIM ISMAJLI		NDËRMARRJA PRIVATE DEM		KULMARE PARA TË NËNTËS						SHTERPE
AKTORI AMERIKAN NË FOTO EDÉARD							TITAN			E FRIKËSOVA QË ËSHTË ME TINGUJ TË ÇRREGULLUAR					BASHKËT. U THA	
LIDHJA, SHOQATA							E PESHOVA FRYMA					QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJT FEMRA LUFTËTARE (mit. greke)				
LISNAJË, PYLL ME LISA						SKUQJA E LWKURWS NGA ZGJERIMI I KAPILARWWE PATRIOTI RRUSTEMI							VEGËL MUZIKORE KATËR (romak)			
INTENSITET, TITAN				DAFINË TRUP QIELLOR				PREMTIMI QË JEPET PËR TË BËRË DIÇKA NOTË MUZIKORE						ERBIUM LIDHJA E ZHIVËS ME NJË METAL TJETËR		
“TETOVA”			BASHKËT. QË KA TË BËJË ME ATAVIZMIN		AKTORJA MUÇOLLI OLIVER NEUVILLE						DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS KRYEMURGU					
KALIBËR I TYTËS SË ARMËS							GURRA KANDËRR E VOGËL DHE E ZEZË QË BREN DRURIN			ADEM ZAJMI INSTITUCION I LARTË SHKENCOR				SHKRONJA XVIII RAMADAN AVDIU		BASHKËT. EMËRTIM I PËRCAKTUAR MIRË DHE I PËRPIKTË I NJË NOCIONI
SHUMË I MADH DHE I FUQISHËM								PËRPUNIM I HOLLËSISHËM I NJË PROJE- KTI (sh.pashq.) PËREMËR PRONOR								
EPOKA ERE	DAULLJA	KYÇ GYP NËPËR TË CILËT KALON GJAKU (shq.)			PROFESIONI	TËRËSI E VEPRIMEVE TË NJË KULTI FETAR			HENDEK PËR TË UJITUR (sh.pashq.) PASIM (sport)							I AFROVA (bised.)
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KARLOS						INVA MULA SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI			SHPEND ME QAFË TË GJATË LLOJ BUKE				I HIRTË; I PËRHIMËT GJAKATAR			
I NJËSUAR, I BASHKUAR							SHKRIMTARI MEKULI (shq.) BASHKËT.					THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI “A” para dy “S”				
EURO - DËPUTETJA GJERMANE DORIS ...				SHEGË PYLL				KAMPIONE MOLDAVIA			AUTOMOBILE ASSOCIATION MALAYSIA NJËSI PESHE (vjet.)				BASHKËT. RRALLË (Lat.)	
ZANORE		AFËRDITA DRESHAJ	MUNICIPAL ART SOCIETY VLORA OSMANI				MIMOZA MUSTAFA TEDI ARBELOA		QYTET NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË NOTË MUZIKORE							
ANIJATAT								FUTBOLLISTI YNË EMRA (shq.) BASHKËT.						ARTIOLA TOSKA ZANORE		
IDHULLI						LECKA PËR ARNIM				ZANOE		VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA				

ZGJIDJHA E FJALEKERYQYT: I PAKKALITUR, PARABIMA, KK, AKOMODIMI, O, KTN, NE, ILIRI, RI, MERIL, KI, Y, MINIM, KAN, ELIOT, ARAP, R, NP, SKAPE, NORTON, TI, E TURA, S, UNION, E MATA, KUVI, LISNI, ERITEMA, UTE, ITI, I, LAR, ZOTIMI, ER, TE, P, VALINA, AVARI, ETALON, AMA, AZ, M, L, TITANIK, ELABORATE, AN, RIT, KANALE, TEVEZ, IM, PATA, GRI, UNITAR, ESADI, KAMA, PAK, NAR, ASE, AAM, V, A, MAS, MM, MOSTARIM NAVATAT, ULIKSI, AT, IDOLI, ARNA, A, LIRA.

www.facebook.com/gjeipuneshpeite



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage - Ministry for the Kosovo Security Force



BËHU KADET I FSK-së! BËHU OFICER I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!

K O N K U R S

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall konkurs për pranimin e kadetëve për Forcën e Sigurisë, për vitin akademik 2018/19, të cilët do të studiojnë në këto qendra:

- 1) Qendra për Studime Universitare e FSK-së**
-Universiteti Amerikan në Kosovë
- 2) Republika e Turqisë**
-Akademia Ushtarake Mjekësore
- 3) Republika Federale e Gjermanisë**
-Kursi i Shkollimit për Oficer Logjistike
-Kursi i Shkollimit për Oficer të Xhenios/Inxhinieri
- 4) Republika e Maqedonisë**
-Akademia Ushtarake

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 21 Maj 2018 deri më 08 Qershor 2018

Web: www.mksf-rks.org / Tel: 038- 603-355/199